

RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	
EMËRTIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Projektligj “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” ¹ ...
MINISTRIA UDHËHEQËSE	Ministria e Energjisë dhe Infrastrukturës
FAZA E POLITIKËS/VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Finale
BURIMI I PROPOZIMIT TË POLITIKËS	Transpozim i BE-së
DIREKTIVË/RREGULLORE E BE-së	Direktiva (EU) 2018/1972 e Parlamentit Evropian dhe Këshillit e datës 11 dhjetor 2018 “Për krijimin Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike” Numri CELEX 32018L1972, Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 321, datë 17.12.2018, faqe 36–214 Link: https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32018L1972
PUBLIKIMET DHE STRATEGJITË E LIDHURA	VKM nr. 434 datë 3.6.2020, “Për miratimin e Planit Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale, Broadband 2020-2025”; VKM-së nr. 636 datë 29.7.2020 “Për miratimin e programit shumëvjeçar për politikën spektrale dhe të planit të veprimit” Strategjia Kombëtare Për Zhvillim dhe Integrim 2015-2020. Strategjia Ndërsektoriale Axxhenda Dixhitale e Shqipërisë 2022-2026.
DATA E KONSULTIMIT PUBLIK	30/11/2022
DATA E VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	18/10/2022
A E KA SHQYRTUAR KRYEMINISTRIA VLERËSIMIN E NDIKIMIT?	Po
NËSE PO, JEPNI DATËN E SHQYRTIMIT	13/09/2022
NUMRI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT	Viti– ML – Nr. VN
TE DHËNA KONTAKTI (EMRI, E-MAIL, NUMRI I TELEFONIT TË PERSONIT TË KONTAKTIT)	Irena Malolli irena.malolli@infrastruktura.gov.al ; +35542222245 Anisa Gjondedaj Anisa.gjondedaj@infrastruktura.gov.al ;
PJESA 1: PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE (maksimumi 2 faqe)	
PËRKUFIZIMI I PROBLEMIT	
<p><i>Cili është problemi në shqyrtim dhe cilat janë shkaqet e tij? Jepni arsyet e nevojës së ndërhyrjes së qeverisë. (jo më shumë se 10 rreshta)</i></p> <p>Teknologjia digjitale po luan një rol gjithnjë e më të rëndësishëm në jetën ekonomike dhe sociale. Rretet e telekomunikacionit/komunikimeve elektronike dhe lidhja në internet me kapacitet shumë të lartë përbejne sot një infrastrukturë kyçe për komunikimin e të dhënave e ngjashme me rrugët, hekurudhat, portet dhe aeroportet janë thelbësore për transportin e mallrave dhe njerëzve. Tregu i telekomunikacioneve në Shqipëri është një treg i liberalizuar dhe i hapur për</p>	

konkurrencë të plotë nga viti 2008 me miratimin e ligjit nr. 9918 date 19.8.2008 “Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar. Ofrimi i rrjeteve dhe përdorimi i shërbimeve të komunikimeve elektronike është zhvilluar dhe rritur vit pas viti bazuar si në rrjetet fikse të komunikimit ashtu dhe ato celulare. Duke qenë se transporti/komunikimi i të dhënave është gjithnjë e më i rëndësishëm në ekonominë dhe jetën tonë shoqërore, është thelbësore që Shqipëria të investojë në këtë infrastrukturë në mënyrë që të mbetet konkurruese dhe të lejojë hapjen e bizneseve dhe vendeve të reja të punës.

Këshilli i Ministrave miratoi në vitin 2020, me VKM Nr. 434, datë 3.6.2020 Planin Kombëtar 2020-2025 për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband, i cili paraqet qëndrimin e qeverisë dhe harmonizon këndvështrimet dhe perspektivat e të gjithë aktorëve në lidhje me vizionin aktual dhe të ardhshëm të Planit Kombëtar të Broadband, objektivat e tij të përgjithshme dhe qëllimet e tij specifike. Vizioni i këtij dokumenti është që Shqipëria, për të hedhur themelet e një shoqërie Gigabit, duhet të ketë infrastrukturë digjitale Broadband me shpejtësi të lartë (high) dhe shumë të lartë (very high) në të gjithë vendin.

Ndërkohë që është bërë progres në drejtim të investimeve në infrastrukturën digjitale, Shqipëria duhet të përshpejtojë investimet në Rrjetet e komunikimit elektronik me Kapacitet Shumë të Lartë (VHCN), në mënyrë që të përmbushë objektivat e Planit Kombëtar 2020-2025 për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband² dhe të sigurojë që biznesi dhe qytetarët të kenë mundësi të marrin pjesë plotësisht në “*Shoqërinë Gigabit*”.

Tregu i komunikimeve elektronike (telekomunikacioneve) përballet me një sërë sfidash:

- Shtirirja e rrjeteve fikse Broadband është shumë e ulët në zonat rurale dhe ekziston një hendek i ndarjes digjitale midis zonës urbane dhe rurale;
- Kërkesat për kapacitet të rrjeteve të telekomunikacionit për internet (si për rrjetet fikse ashtu edhe ato celulare), po rriten me shpejtësi;
- Këta faktorë kërkojnë më shumë investime të përshpejtuara, për të plotësuar këto nevoja dhe për të arritur objektivat e shoqërisë gigabit, ndërkohë që konkurrenca me ofruesit e Over the Top (OTT) rritet.
- Ka një numër të kufizuar operatorësh më të mëdhenj, të cilët po konsolidohen duke synuar operimin në një bazë më rajonale dhe duke ulur potencialisht ofertën në treg, gjë që mund të çojë në reduktim të ekonomisë të shkallës;
- Operatorët privatë kanë zhvilluar rrjetet mobile Broadband, në brezat 3G dhe 4G, por rrjetet 5G që janë të rëndësishme për zhvillimet e të ardhmes, nuk janë ende të pranishme;
- Ka një bashkëpërdorim të kufizuar të infrastrukturës ekzistuese dhe inxhinierisë civile si dhe proceset e lejeve të ndërtimit dhe sigurimi i drejtës së kalimit mund të jenë të vështira.

Zhvillimi i shpejtë i teknologjive digjitale dhe shfaqja e formave të reja të komunikimeve përmes rrjeteve të komunikimit elektronik/telekomunikacioneve, krijon mundësi por dhe sfida të reja në aspektet rregullatore, që duhen mbajtur parasysh në hartimin e politikave të reja.

Në raportet e fundit të BE-së për Shqipërinë³, rekomandohet të "*vazhdohet puna për miratimin e ndryshimeve të nevojshme në Ligjin për Komunikimet Elektronike, në përputhje me Kodin e ri Evropian të Komunikimeve Elektronike dhe të miratohet plani i veprimit për agjendën digjitale*".

Kodi i ri Evropian i Komunikimeve Elektronike, përbën një reformë politike të rëndësishme për zhvillimin e rrjeteve me Kapacitet Shumë të Lartë (VHCN), si ato me fibër, ashtu edhe ato 5G.

² VKM Nr.434, 3.6.2020;

³ Raporti i Shqipërisë 2020 SWD(2020) 354 Dokumenti përfundimtar i punës së stafit të Komisionit;

Rregullimi i tregut të komunikimeve elektronike parashikon vendosjen e masave rregullatore mbi bazën e analizave të tregjeve përkatëse, përcaktimin e operatorëve me fuqi të ndjeshme në treg (SMP) dhe rishikim periodik të tyre. Kuadri ekzistues ligjor nuk ka rregullime ose parashikime të qarta për teknologji të reja, rrjetet e kapaciteteve të larta dhe shumë të larta, apo rregullime për shërbimet e komunikimeve ndërpersonale (të pavarura nga numri), që dalin të nevojshme nga zhvillimi teknologjik dhe ndikimi i madh i tyre në të gjitha zhvillimet digjitale.

OBJEKTIVAT

Cilat janë objektivat dhe rezultatet e synuara të propozimit? (jo më shumë se 7 rreshta)

Objektivat e synuara që duhet të arrihen përmes kësaj politike mund të përmbliken si:

- a) Përshpejtim i zhvillimit dhe investimit në infrastrukturën digjitale (përkatësisht rrjetet VHCN), për të adresuar kërkesën më të lartë për konektivitet digjital dhe shoqërinë gigabit me qëllim rritjen e penetrimit fiks broadband fiks me 30% brenda tre viteve të para;
- b) Harmonizimi me direktivën e BE-së për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike brenda vitit 2022.
- c) Reduktim i dallimeve në mbulimin urban/rural dhe sigurim i zbutjes së ndarjes digjitale; Ulja e kostos së shtrirjes së rrjetit, përmes bashkëpërdorimit të infrastrukturës passive, duke inkurajuar investimet në modelet konkurruese të biznesit;
- d) Harmonizim dhe koordinim i politikave të spektrit, për të siguruar akses në ekonomitë e shkallës në Shqipëri;
- e) Zhvillim i politikave konkurruese të fuqishme dhe të orientuara drejt tregut, të cilat sigurojnë një ofertë të larmishme për konsumatorin dhe promovojnë investimet midis operatorëve;
- f) Masa harmonizuese në lidhje me të drejtat e konsumatorëve;
- g) Zgjerim i qëllimit të kuadrit rregullator, për të mbuluar disa shërbime të komunikimit ndërpersonal (të pavarura nga numri), të cilat më parë ishin të parregulluara.
- h) Legjislacioni shqiptar të jetë në përputhje me standardet dhe legjislacionin e BE-së, duke rritur kështu aftësinë e Shqipërisë për të marrë përsipër detyrimet e saj të anëtarësimit.

Konektiviteti digjital, njihet si forca shtytëse themelore për shoqërinë dhe ekonominë digjitale, mbështetur nga ndryshimet teknologjike dhe kërkesat në zhvillim të konsumatorëve dhe të tregut. Paraqitet e nevojshme që objektivat aktuale të kuadrit rregullator ekzistues, duhet të shoqërohen nga një objektiv i ri i konektivitetit i gjendur në EECC, i përcaktuar si: *Qasja dhe mundësia i internetit me kapacitet shumë të lartë, si fiks ashtu edhe celular për të gjithë qytetarët dhe bizneset evropiane, si dhe shërbimet e komunikimit ndërpersonal, mbi bazën e çmimeve dhe zgjedhjeve të përballeshme, të mundësuar nga konkurrenca efektive dhe e ndershme, nga investimet efikase me kthime të përshtatshme, nga inovacioni, nga rregullat e përbashkëta dhe qasjet e parashikueshme rregullatore në tregun e brendshëm duke mbrojtur interesat e qytetarëve.*

Objektivi i ri sipas praktikës evropiane të EECC⁴, do t'u shtohet objektivave tashmë ekzistuese, për promovimin e konkurrencës dhe interesave të qytetarëve.

Këto duhet të konceptohen si një e tërë, në përputhje me strategjitë e politikave për koherencën e objektivave, në veçanti me strategjinë e konektivitetit, e cila kuptohet rreth tre grupeve të ambicieve specifike:

- a. Konektiviteti Gigabit për drejtuesit socio-ekonomikë
- b. Konektivitetet celular i kudogjendur
- c. Përmirësimi i konektivitetit në zonat rurale.

OPSIONET E POLITIKAVE

⁴ Direktiva 2018/1972/EU <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32018L1972>

Cilat janë opsionet kryesore të politikave, duke përfshirë mënyrat ndaj rregullimit? Duhet të bëni krahasimin e avantazheve/përfitimeve kryesore dhe të disavantazheve/kostove të opsioneve të mundshme. Duhet të përcaktoni detajet në lidhje me opsionin e preferuar.

Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:

Opsioni 0: Status quo-ja, mos ndryshimi i gjendjes aktuale;

Opsioni 1: Derregullimi; ku shumica e rregullave hiqen përmes një amendimi të ligjit ekzistues;

Opsioni 2: VHCN; opsioni ku fokusi zhvendoset në sigurimin e investimeve në rrjetet VHCN – miratimi i një ligji të ri

1.

Opsioni 0- Status quo-ja, mos ndryshimi i gjendjes aktuale

Nuk ndërhyhet me ndryshime apo politikë të re, gjë që na çon në situatën ku mbeten problematikat aktuale. Ndikimet ekonomike të këtij opsioni përfshijnë/ndikojnë veçanërisht në boshllëqet e dukshme në aftësitë e rrjeteve të komunikimit elektronik (konektiviteti digjital me shpejtësi të lartë), që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve tek familjet dhe bizneset që lidhen me aplikacione të tilla si “clouds computing” si dhe në marrjen e shërbimeve të tjera që kërkojnë lidhje me gjerësi bande të lartë dhe/ose simetrike (të tilla si televizioni i gjeneratës së ardhshme, video-konferencat, edukimi, e-health dhe aplikacionet e monitorimit në distancë).

Nga ana tjetër, lidhjet e dobëta në konektivitetin brenda vendit, mund të kenë ndikime më të gjera në atraktivitetin e Shqipërisë si një qendër për inovacionin dhe zhvillimin e biznesit në TIK. Në këtë kontekst, duhet mbajtur parasysh që kanë industri të mirëzhvilluara të TIK-ut, janë mbështetur nga nxitja e hershme e investimeve për lidhje/konektivitet me shpejtësi shumë të lartë⁵.

Gjithashtu një studim i përgatitur për Komisionin e BE-së në vitin 2015⁶, duke përdorur analizën ekonometrike dhe modelimin makro-ekonomik, vlerëson se arritja e shpejtësive mesatare të pritshme në një skenar të plotë me fibra, deri në vitin 2025, do të rriste PBB-në evropiane me 2% krahasuar me status quo-në dhe me 0.7% në një skenar në rritje me shpejtësi të lartë.

Rrjetet celulare 4G dhe ato 5G varen nga “fiber backhaul” për të përmbushur kërkesat për “vonesën e ulët/low latency” të nevojshme për aplikacione të tilla si telemjekësia, apo aplikacione të tjera që kërkojnë cilësi të lartë shërbimi.

Mungesa e ndërmarrjes së veprimeve për përshpejtimin e zhvillimit dhe investimeve në infrastrukturën digjitale (përkatesisht rrjetet VHCN), për të adresuar kërkesën më të lartë për konektivitet digjital dhe shoqërinë gigabit, do të kishte implikime negative si për aplikacionet në celular, ashtu dhe ato dhe fikse.

Ndikimi ekonomik i këtij opsioni mund të shoqërohet me koston oportune të dështimit, duke penguar vendosjen e infrastrukturës së nevojshme, për të përdorur gjerësisht shërbimet e avancuara, duke përfshirë 5G-në.

Zhvillimi i rrjeteve 5G lidhet ngushtë dhe me çështjet e menaxhimit të spektrit. Nëse do kishim opsionin pa ndryshime duhet mbajtur parasysh se:

⁵ Për shembull, në Japoni, ku broadband me mbulim shumë të shpejtë kishte arritur në 90% deri në vitin 2012, tregu i TIK-ut përbënte rreth 8.9% të të gjitha industrive dhe 7.1% të punësimit total. Në të kundërt, mbulimi i BE-së në BE ishte rreth 53%, punësimi i TIK-ut në BE përfaqësonte vetëm 4% të PBB-së dhe 2.7% të punësimit total në BE në 2011

⁶ WIK 2015, Mbështetje për përgatitjen e vlerësimit të ndikimit që shoqëron rishikimin e kuartrit rregullator për komunikimet elektronike (SMART 2015/0005), Studim për Komisionin Evropian (2015-2016) 6 Relevant market – shiko përcaktimet në ligjin 9918 date 19.5.2008 për komunikimet elektronike në RSH.

Kuadri -rregullator i BE-së i Vitit 2002, i zhvilluar në një kohë kur telefonja celulare ishte ende në fazë zhvillimi, krijoi fleksibilitet për Qeveritë në menaxhimin e radio frekuencave dhe procedurave të transferimit të të drejtave, sipas parimeve të përgjithshme të përcaktuara në legjislacion. Në të njëjtën kohë, për të mbështetur koordinimin e politikës së spektrit, u krijuan dy organe: (1) Vendimi për Spektrin e Radios i vitit 2002 themeloi Komitetin e Spektrit të Radios (RSC⁷), që ka përgjegjësinë për masat teknike të kërkuara për zbatimin e politikës më të gjerë të spektrit të radios, dhe (2) Grupi i Politikës së Spektrit të Radios (RSPG), i krijuar sipas Vendimit të Komisionit 2002/622/KE, i përbërë nga Shtetet Anëtare, përfaqësuesit e Komisionit dhe që u krijua si një grup këshillues për Komisionin. RSPG nxjerr opinione dhe raporte mbi Politikën e Spektrit Radio me kërkesë të Komisionit dhe së fundmi nën një kompetencë të zgjeruar edhe Parlamentit Evropian ose Këshillit. Shqipëria është në statusin e vëzhguesit pranë këtyre organeve.

Rishikimi i vitit 2009 në kuadrin ligjor të komunikimeve elektronike, dha udhëzime të reja të rëndësishme për menaxhimin e spektrit, pasi komunikimet celulare po fitonin rëndësi dhe spektri shihej gjithnjë e më shumë si kontribut thelbësor për të konkurruar në tregun e komunikimeve elektronike. Më e rëndësishmja, në këtë mënyrë u hap rruga për Programin e Politikës së Spektrit të Radios 2012 (RSPP), i cili tani shërben si një udhërrëfyes për zhvillimin e tregut të brendshëm për një gamë të gjerë teknologjish dhe shërbimesh me valë (d.m.th. jo vetëm për komunikimet elektronike), duke marrë parasysh si “Evropa 2020” ashtu edhe “Agjendën Digjitale për Evropën”. Megjithatë, në kundërshtim me atë që ndodh me rregulloren e aksesit dhe 'nenin 7' të saj, dispozitat e reja për menaxhimin e spektrit nuk përfshinin masa për një vlerësim më të gjerë të projekt-masave kombëtare, në veçanti caktimin e të drejtave të përdorimit të spektrit.

Opsioni 1 - Rregullim më i lehtë, ku shumica e rregullimeve ekonomike hiqen duke u mbështetur në rregullimin simetrik

Sipas kuadrit rregullator aktual, analiza e tregjeve (tregjet përkatëse⁸), mund të rishikohen çdo dy vjet dhe aty ku kemi përcaktim të dominimit ekonomik (Operatorë me fuqi të ndjeshme në treg ose SMP), mund të vendosen një sërë detyrimesh nga AKEP për ato firma me status OFNT/SMP.

Ky opsion parashikon një reduktim të konsiderueshëm të shtrirjes së rregullimit të aksesit specifik për sektorin, nëpërmjet një klauzole për rregullimin ex-ante në zonat ku janë të pranishme dy ose më shumë infrastruktura, duke kaluar kështu nga rregullimi specifik i komunikimeve elektronike ex- ante në mjedisin ku NRA-të do të mbikqyrnin tregun vetëm sipas nevojës dhe sektori i komunikimeve elektronike do t'i nënshtrohej kontrollit ex-post të ligjit të konkurrencës.

Me këtë opsion në rregullim preferencë do i jepej marrëveshjeve të negociuara komercialisht ndërmjet ofruesve të aksesit dhe kërkuesve të aksesit, pa pasur nevojë për të kryer analiza të rregullta të tregut dhe për të miratuar paraprakisht ofertat e referencës, siç është në kuadrin aktual. Megjithatë, AKEP-it do t'i mbetej mundësia për të ndërhyrë në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, potencialisht në të gjithë segmentet e tregut dhe zonave gjeografike, por veçanërisht aty ku është e pranishme vetëm një ofrues i infrastrukturës broadband.

Kompetencat e AKEP-it do të përfshinin mundësinë e rregullimit të furnizimit me shërbime me shumicë, por kjo do të ishte në formën e një produkti të vetëm aksesit, që synon të zgjidhë problemin specifik të aksesit të identifikuar në mosmarrëveshje. Tërheqja me faza e procesit të analizës së tregut sipas këtij opsioni, do të nënkuptonte gjithashtu një reduktim të kompetencës për MIE. Proçesi i analizës së tregut të përcaktuar në nenet 31-35 të ligjit 9918, nuk do të ishte më i nevojshëm dhe mund të hiqej.

⁷ Shiko <https://ec.europa.eu/digital-agenda/radio-spectrum-committee-rsc>

⁸ Relevant market – shiko përcaktimet në ligjin 9918 date 19.5.2008 për komunikimet elektronike në RSH.

Në lidhje me pjesën e frekuencave në këtë opsion do kishim adoptimin e Rregullave jodetyruese për rritjen e konsistencës së menaxhimit të spektrit.

Në këte rast do kishim përshtatjen në mënyrë graduale e kuadrit ligjor, me zhvillimet e vazhdueshme dhe të pritshme, për sa i përket konektivitetit të kudogjendur dhe shtrirjes së rrjetit 5G dhe për këtë arsye të futet gradualisht në disa aspekte të menaxhimit të spektrit duke (i) përcaktuar objektivat dhe parimet e lidhura me kuadrin e spektrit (ii) propozuar Nenin 19 të rekomandimit të Komisionit “për disa aspekte të caktimit të spektrit”, (iii) përfshirë një procedurë vullnetare të ankandit shumëkombëtar dhe duke sqaruar kushtet e përbashkëta dhe (iv) propozuar masa për të mbështetur shtrirjen e rrjeteve shumë të dendura të qelizave të vogla dhe aksesin në rrjetet Wi-Fi.

Prezantimi i objektivave dhe parimeve më specifike të lidhura me spektrin të shoqëruara këto objektiva me një rekomandim të veçantë jo-detyrues të Komisionit, bazuar në Nenin 19 të Direktivës Kuadër, i cili do të përcaktonte kohën e dhenies dhe rinovimeve, kriteret e përbashkëta për procesin e dhënies dhe modelin, tarifat e dhënies dhe kushtet e pagesës si dhe përcaktimin e kushteve më të rëndësishme të caktimit për vendimet e investimit dhe nxitja e tregut të vetëm, të tilla si kohëzgjatja e licencës, mjetet për të përcaktuar dhe arritur detyrimet e mbulimit, tarifat e ankandit, tregtimin, dhënien me qira dhe kushtet e ndarjes/bashkeperdorimit, ri-farming, efikasitetin e spektrit në lidhje me kërkesat teknike, masat e formësimit të tregut si sasia maksimale/kufijtë e spektrit, rezervimi i spektrit ose detyrimet e shitjes me shumicë bazuar në nenin 5 RSPP.

Prezantimi i dispozitave për vendosjen e qelizave të vogla (smallcell), për të reduktuar kostot e vendosjes së rrjeteve shumë të dendura dhe aksesin në WI-FI, për të përmbushur kërkesën eksponenciale për konektivitet të kudogjendur, duke i ofruar industrisë IoT spektër me kosto të ulët.

Opsioni 2 - Një politikë e re që vendos fokusin në sigurimin e investimeve në Rrjetet me Kapacitete Shume të Larta (VHCN⁹)

Ky opsion kërkon vendosjen në fokus objektivin për rrjete me kapacitete shume të larta, si një nevojë për të gjitha zhvillimet e pritshme për ekonomine digjitale, si dhe përcaktimin e rregullave më të qarta për rrjetet e komunikimeve elektronike, të drejtat e përdorimit të frekuencave, apo burimeve të tjera fundore, si dhe mekanizmat e duhur institucionalë e rregullatorë. Për këtë qëllim është e nevojshme hartimi i një ligji të ri.

Ndikimet ekonomike të këtij opsioni, rrjedhin kryesisht nga zgjerimi i Broadbandit VHC (very high capacity) dhe në shërbimet e përmirësuara të Broadband në një ekonomi më të gjerë.

Rrjetet me Kapacitete Shume të Larta përfshijnë rrjetet fikse me fibër optike deri në pikën fundore të rrjetit si dhe rrjetet e gjeneratës së ardhme mobile si 5G. Kjo e dyta lidhet ngushtë me çështjet e menaxhimit, administrimit dhe koordinimit të spektrit të frekuencave.

Një analizë ekonometrike¹⁰ e kryer për Komisionin e BE-së, gjeti një lidhje midis rritjes së shpejtësisë mesatare të Broadbandit dhe produktivitetit të faktorëve totalë, në një numër sektorësh. Analiza sugjeron që rritja e vlerësuar e shpejtësisë dhe cilësisë, të lidhura me arritjen e të gjithë FTTH, në të gjithë BE-në, deri në vitin 2025, do të rezultojë në nivele të PBB-së 2% më të larta se

⁹ Very High Capacity Network (VHCN)

¹⁰ Shtator 2016 - Regjimet rregullative, në veçanti të aksesit, për modelet e investimeve në rrjet në Evropë - Një studim i përgatitur për Rrjetet, Përbajtja dhe Teknologjia e Komunikimit të DG të Komisionit Evropian nga WIK, Deloitte dhe IDATE. ISBN 978-92-79-61823-9

status quo-ja deri në vitin 2025, ose një rritje prej 0.76% mbi status quo-në, në një skenar realist, në të cilin 62% e lidhjeve Broadband bazohen në FTTH/B deri në vitin 2025.

Gjetjet konfirmojnë atë që literatura sugjeron: mbi dhe përtej përfitimeve ekonomike që rrjedhin nga Broadbandi standard¹¹, rrjetet VHC mund të sjellin përfitime në drejtim të rritjes së punësimit dhe produktivitetit, duke kontribuar në rritjen e PBB-së.

Përvoja nga zbatimi i kuadrit rregullator në Portugali, Spanjë dhe Francë, sugjeron që ndjekja e një strategjie rregullatore, e cila nuk imponon detyrime "standarde" të aksesit për rrjetet e reja VHC të vendosura rishtazi, me kusht që ato të shoqërohen nga masa të forta për t'u mundësuar operatorëve alternativë të 'ngjisin shkallët e investimeve' drejt konkurrencës së bazuar në infrastrukturë në FTTH/B, (siç është një mundësi e arsyeshme për të bashkë-investuar në rrjete të tilla, duct access dhe mirëmbajtja e detyrimeve të aksesit në rrjete në nivelin e performancës përpara upgrade-it), mund të shkaktojë disponueshmëri më të gjerë të FTTH/B, në të gjithë territorin kombëtar.

Masat e përshkruara më sipër, do të nxisin konkurrencën në infrastrukturë, në zonat ku në mungesë të dispozitave efektive për aksesin në kanal/pol nuk do të kishte funksionuar, duke krijuar një fushë konkurrence të barabartë midis operatorëve aktualë dhe konkurrentëve. Analiza e shkaqeve themelore të investimeve jooptimale, tregon se zgjidhjet rregullatore nuk e zgjidhin automatikisht problemin e investimeve, pasi disa nga faktorët që ndikojnë në investime janë të natyrës makroekonomike ose socio-ekonomike.

Përvoja suedeze në Evropë, tregon se modelet vetëm me shumicë, të përbëra nga rrjete komunale dhe private, mund të ndihmojnë në zgjerimin e gjurmës së NGA, duke u fokusuar në modelet e investimeve në infrastrukturë me kthime më të gjata në kapital, duke tërhequr investitorë që kanë nevojë për kthime më të ulëta por të vazhdueshme dhe të shtrira në një kohë më të gjatë. Kjo është gjithashtu koherente me iniciativat e tjera të BE-së, të tilla si CEF/EFSI, eliminimi i rrezikut të projekteve të investimeve nëpërmjet instrumenteve financiare, të cilat mund të zbatohen lehtësisht për financimin e projekteve të infrastrukturës si rrjetet VHC. Në përvojën suedeze, agregimi i kërkesës nxitet edhe nga mundësia e "pagesës paraprake", e cila imitohet nga masa e propozuar për pagesat me këste, e përshtatshme për zonat rurale ku shumë banorë zotërojnë pronat e tyre. Në këtë mënyrë, pronarët e rrjetit mund të marrin angazhime nga një masë kritike e banesave të synuara në një zonë të caktuar (normalisht 20%-40% të pronave), përpara se të fillojnë ndërtimin. Më afër Shqipërisë, lulëzuan projekte të tjera si në Kosovë. Me Projektin e Ekonomisë Digjitale (KODE), shteti ndau grante për ISP-të, nëpërmjet një sërë marrëveshesh grantesh që përputhen, ku secili mbulon shumë zona kadastrale të ndryshme. Operatorët e komunikimeve elektronike me propozimet më të favorshme ekonomikisht, ndërtojnë, menaxhojnë dhe shfrytëzojnë komercialisht rrjete Broadband publikisht të bashkëfinancuar. Pas përfundimit të shtrimit të infrastrukturës Broadband, shteti nuk do të marrë asnjë rol në pronësinë ose funksionimin e rrjeteve. Operatorët morën një sërë detyrimesh që janë në përputhje me qasjen e BE-së, për rregullimin e projekteve të bashkëfinancimit publik të Broadband.

Duhet të theksohet gjithashtu se mbulimi i konektivitetit me gjerësi bande shumë të lartë në Portugali dhe Spanjë, është shtrirë përtej zonave urbane të dendura, duke arritur në 83% të të gjitha familjeve në Portugali dhe 88% të të gjitha familjeve në Spanjë.¹²

Për sa i përket spektrit, ekziston një konsensus i gjerë midis politikëbërësve, industrisë dhe studiuesve, se është i nevojshëm një koordinim më i madh i detyrave dhe menaxhimit të tij. Një

11 Për shembull, Waverman, L. (2009, 29 shkurt). Ndikimi ekonomik i broadbandit: Një studim empirik. Londër: LECG zbulon se një rritje prej 1% në penetrimin e brezit të gjerë në vendet me të ardhura të larta dhe të mesme çon në 0.13% rritje të produktivitetit

12 FTTH Këshilli i Evropës, Panorama e Tregut 2021 – Të dhënat në shtator 2020. E disponueshme në <https://www.ftthcouncil.eu/>

raport i Parlamentit Evropian thotë se: "Koordinimi më i fortë i menaxhimit të spektrit ka të ngjarë të nxisë inovacionin, duke lejuar krijimin e ekonomive të shkallës në nivel evropian, kur caktohet spektri i harmonizuar dhe përdorimi i njëkohshëm dhe reduktimi i pasigurive për të përsheptuar investimet në rrjetet 4G¹³." Koordinim më i madh për spektrin është miratuar gjithashtu në Konkluzionet e Këshillit Evropian (qershor 2016)¹⁴, që njohën nevojën për të krijuar kushte të duhura për stimulimin e mundësive të reja të biznesit, duke koordinuar më mirë modalitetet e caktimit të spektrit. Kësaj i është bërë jehonë nga operatorët kryesorë dhe palët e tjera të interesuara në Manifestin për një shtrirje në kohë të rrjetit 5G në Evropë¹⁵ dhe një raport GSMA i cili konstaton se "një komponent kyç i strategjisë [...] përfshin propozime për kushte të koordinuara në mbarë BE-në, për menaxhimin e politikave të spektrit. [...] faktorë të ndryshëm - duke përfshirë kohën dhe projektimin e ankandeve të spektrit; kostoja, kohëzgjatja dhe kushtet e licencave - të gjitha kanë një ndikim të madh në disponueshmërinë, koston, cilësinë dhe shtrirjen e shërbimeve¹⁶ celulare Broadband". Plani kombëtar i Shqipërisë për Broadband-in¹⁷, rendit menaxhimin e spektrit si një nga katër prioritetet kryesore për arritjen e objektivave të Broadband. Së fundi, kërkimet akademike si Bohlin, Caves dhe Eisenach (2014), pajtohen se "nëse performanca e tregjeve celulare (wireless) të BE-së do të përmirësohej, po njësoj do të ndodhte dhe me mirëqenien e konsumatorit e cila do të rritej, duke reduktuar fragmentimin midis furnitorëve, duke i lejuar ata të kapin ekonomitë e shkallës dhe qëllimin; dhe, duke hequr barrierat, duke rritur stimujt për investime dhe inovacion, duke përsheptuar vendosjen e gjeneratës së ardhshme të infrastrukturave Broadband pa tel dhe duke përsheptuar rritjen e ekosistemit celular pa valë (wireless mobile)"¹⁸.

Opsioni i pranuar për frekuencat: Rregulla detyruese dhe të zbatueshme për përmirësimin e koordinimit të menaxhimit të spektrit me një fokus më të madh për të përshtatur rregullat e spektrit me sfidat e 5G në të ardhmen. Ky opsion do të përfshinte të gjitha masat e propozuara në opsionin 2. Megjithatë, objektivat dhe parimet e lidhura me spektrin në kuadër, që janë në këtë opsion, do të ishin të detyrueshme. Për më tepër, ky opsion do të vendosë një theks më të madh në mjedisin e investimeve për rrjetet e dendura 5G, si dhe në sigurimin e qëndrueshmërisë më të madhe në lidhje me masat e BE-së që ndikojnë në kushtet e tregut konkurrues dhe rregullimin ekonomik.

ANALIZA E NDIKIMEVE

Cilat janë ndikimet e opsionit të preferuar? Kjo duhet të përshkruajë ndikimet në mënyrë sasimore (monetare) dhe cilësore (narrative) mbi buxhetin dhe grupet e tjera të prekura. (jo më shumë se 10 rreshta)

Ndikime jo të drejtpërdrejta: zbatimi i politikës së re, sjell përfitim për të gjithë sektorët e ekonomisë në edukim, transport, energji, shëndetësi, institucionet publike etj.

Operatorët Ekonomikë/Biznesi: Në Shqipëri në fund të vitit 2021, rezultonin të autorizuar nga AKEP, për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, mbi 200 sipërmarrës.

Për **qeverinë**, opsioni i preferuar do të sjellë arritjen e një objekti strategjik për një shoqëri gigabit.

Qytetarët do të përfitojnë pasi zhvillimi i infrastrukturës të komunikimeve elektronike dhe shërbimet e ofruara mbi to me cmime të përbalueshme dhe të kudondodhura, rrisin mundësinë e

¹³ Parlamenti Evropian, Reformimi i rregullave të telekomunikacionit të BE-së për të krijuar Unionin Dixhital, 2016

¹⁴ <http://data.consilium.europa.eu/doc/document/ST-26-2016-INIT/en/pdf>

¹⁵ <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/news/commissioner-oettinger-welcomes-5g-manifesto>

¹⁶ GSMA, përfitimet socio-ekonomike të harmonizimit më të madh të politikave të spektrit në të gjithë Evropën, nëntor 2015

¹⁷ Plani Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Dixhitale, Broadband 2020-2025, Miratuar me VKM nr.434 datë 3.6.2020

¹⁸ Bohlin, Caves dhe Eisenach (2014), Performanca celulare me valë në BE dhe SHBA: Implikimet për politikën, komunikimet dhe strategjitë, nr. 93, T. 1 2014, f. 35. Ky hulumtim u mbështet nga GSMA.

përfitimit nga transformimi digjital dhe përdorimi i TIK nga çdo individ, në marrjen e shërbimeve, aplikacioneve, përdorimin e teknologjive të reja, krijimin e hapësirave për punësim, edukim, e-health, e-commerce etj.

ARSYETIMI I OPSIONIT TË PREFERUAR

Shpjegoni arsytet për zgjedhjen e opsionit të preferuar. Ju lutemi jepni nëse është e mundur koston dhe përfitimin me vlerë të përcaktuar monetare. (jo më shumë se 7 rreshta)

Opsioni i preferuar është përzgjedhur Opsioni 2, pra hartimi dhe miratimi i një ligji të ri "Për komunikimet elektronike në RSH", pasi:

- Legjislacioni i ndryshuar do të përfordojë lidhjen midis objektivit të kuadrit rregullator dhe objektivave të përgjithshme politike të qeverisë shqiptare. Ai do të lejojë Shqipërinë të marrë pjesë plotësisht në zhvillimet e ardhshme të shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, si 5G IoT, ose Inteligjenca Artificiale.
- ofron një model të ri për zhvillimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike shumë të shpejtë mbi bazën e një rregullimi simetrik, bashkëpërdorimin e infrastrukturës dhe burimeve, krijimit të lehtësirave për zhvillimin e rrjeteve dhe shërbimeve në një mjedis rregullator më të përshtatshëm bazuar në zhvillimet teknologjike.
- Ndihmon në reduktimin e ndarjes digjitale përmes zhvillimit të rrjeteve dhe shërbimeve universale të përballueshme dhe gjithëpërfshirëse;
- Përcakton një objektivi të rëndësishëm strategjik për rrjetet e kapaciteteve të larta dhe shumë të larta;
- Sjell standardin e BE-së në këtë fushë, dhe synon garantimin e Kartës së Drejtave Themelore të BE,¹⁹ në zbatimin e rregullave për komunikimet elektronike dhe adresimin e masave të planifikuara në këtë drejtim;
- realizon objektivat politike të qeverisë për zhvillimin e infrastrukturës digjitale dhe ofrimin e shërbimeve elektronike;
- mundëson adresimin e problematikave të tregut;

në këndvështrimin e kostos, opsioni i preferuar rezulton me pozitiv.

Kostoja e përlogaritur në total e opsionit të preferuar mbi buxhetin e shtetit gjatë periudhës 3-vjeçare menjëherë pas miratimit të ligjit (kostoja në total në lek, çmimet aktuale, në terma nominalë):

Viti 1	Viti 2	Viti 3
0	0	0

KONSULTIMI

Jepni një përmbledhje të çdo konsultimi të kryer (me kë dhe si jeni konsultuar? (jo më shumë se 5 rreshta)

Projektligji është hartuar me ekspertë të BE-së, në kuadër të asistencës teknike të BE-së për sektorin e telekomunikacioneve, dhe në bashkëpunim me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) dhe AKEP.

Kjo asistencë teknike ofrohet në bazë të kontratës nga Planet S.A. si pjesë e asistencës së dhënë nga Bashkimi Evropian për Republikën e Shqipërisë nëpërmjet Institucionit të saj të Integritit (EUIF) për vitin 2020. Delegacioni i BE-së në Tiranë, po zbaton projektin nëpërmjet menaxhimit të drejtpërdrejtë si programi i parë në mbështetje të sektorit të telekomunikacionit.

Raundi i parë i konsultimeve mbi këtë proces është kryer me aktorë të ndryshëm gjatë periudhës Janar-Mars 2022. Gjatë takimeve janë identifikuar problemet dhe çështjet e nevojshme për adresim.

Në tabelën e mëposhtme jepen takimet e zhvilluara me institucionet dhe grupet e interesit në raundin e parë të konsultimit:

¹⁹ Vlerësimi i ndikimit në rishikimin e Direktivës 2003/98/KE për ripërdorimin e informacionit të sektorit publik' i BE-së referon hapjen e 100,000 vendeve të punës në total në Shtetet Anëtare të BE-së përmes tregut të open data dhe ripërdorimitëëëëëëëë

• Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)	20-01-2022 (kick of meeting) ne vijim
• Ministria e Financës dhe Ekonomisë (MFE)	04-02-2022
• AKEP	26-01-2022
• AMA	26-01-2022
• Autoriteti i Konkurrencës (AK)	10-02-2022
• Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit (CPC)	31-01-2022
• Komisioneri për informacionin dhe ruajtjen e të dhënave(KDIMP)	01-02-2022
• AMA and Transmetuesit TV	02-02-2022
• ALBtelecom	03-02-2022
• One Telecommunications	03-02-2022
• Vodafone	03-02-2022

Një raund i dytë i takimeve konsultative u mbajt si më poshtë:

• AKEP	07-03-2022
• Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE)	07-03-2022
• Vodafone	07-03-2022
• AMA	08-03-2022
• One Communications	09-03-2022
• MIE	10-03-2022
• ALBtelecom	10-03-2022

Prezantimi i projekligjit në draftin e parë është planifikuar në javën e parë të korrikut 2022.

Projektligji, Raporti i Vlerësimit të Ndikimit dhe Relacioni Shpjegues do të publikohet për konsultim publik në regjistrin elektronik për konsultime publike.

Në vijim u zhvillua në datë 19.9.2022, u zhvillua një takim konsultativ me AKEP dhe operatorët kryesorë të telekomunikacioneve ku operatorët bënë komente, sugjerime mbi draft ligjin. Proçesi i konsultimit përfshin konsultimin me zyrën e Komisionit Evropian, DGCONNET dhe DGNEAR.

ZBATIMI DHE MONITORIMI

Si do të organizohen zbatimi dhe monitorimi?(jo më shumë se 5 rreshta)

Institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e opsionit të preferuar janë:

- MIE si institucion politikëbërës për tregun e komunikimit elektronik/telekomunikacionit;
- AKEP si organ i pavarur rregullator për tregun e komunikimeve elektronike dhe përgjegjëse për zbatimin e mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike;
- AMA si autoriteti rregullator i transmetimeve audiovizive dhe përgjegjës për mbikqyrjen e tregut të medias;
- Institucione të tjera publike/autoritete kompetente të lidhura ose/të ngarkuara për aspekte të tilla si, siguria, përdorimi i spektrit (Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Shërbimi Informativ Shtetëror), Autoriteti i Konkurrencës, Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe të Dhënat Personale, Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit etj. Me të cilët bashkëpunohet nga ministria dhe AKEP për përmbushjen e objektivave të politikës.

Zbatimi i ndryshimeve të politikave të përfshira në opsionin e preferuar do të monitorohet në mënyrë periodike nëpërmjet raporteve vjetore të AKEP, dhe/ose MIE.

Treguesit kryesorë për të matur suksesin e zbatimit të politikave janë:

- Shkalla e penetrimit të broadbandit fikse bazuar në VHCN
- Numri i lidhjeve fikse broadband VHCN - % e mbulimit me rrjete të broadbandit celular të bazuar në VHCN
- Numri i përdoruesve mobile broadband (VHCN-së celulare)
- Përbalueshmëria e çmimeve dhe shërbimeve broadband;
- Shfrytëzimi i shërbimeve digjitale nga biznesi dhe shërbimet publike.

**PJ
ES
A
2:
BA
ZA
KR
YE
SO
RE
E
AN
AL
IZ
ËS
DH
E E
PR
OV
AV
E**

**Hist
orik**

*Jep
ni
kon
teks
tin
e
poli
tikë
s.*

*Qev
eria
shqi
ptar
e
është
e e
ang
azh
uar
për
tran
sfor
mi
min*

digjital dhe përmbushjen e objektivave të Agjendës Digjitale, në kuadër të Strategjisë Kombëtare për

Zhvillim dhe Integrim dhe Programit të Reformave Ekonomike. Zhvillimi i rrjeteve të komunikimeve elektronike, dhe ofrimi i shërbimeve përmes tyre, është sot një domosdoshmëri. Infrastruktura e rrjeteve broadband është infrastrukturë e rëndësishme kritike që mund të luajë një rol domethënës në zhvillimin e mëtejshëm ekonomik dhe social të vendit, si dhe për të shfrytëzuar fuqitë transformuese të Teknologjise së Informacionit dhe Komunikimit në të gjithë vendin. Për rëndësinë që paraqet infrastruktura digjitale, për zhvillimin e gjithë ekonomisë, në veçanti në erën e transformimit digjital, u miratua me VKM nr. 434 datë 3.6.2020, Plani i ri Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale, Broadband 2020-2025, i cili ka përcaktuar si vizion: “Shqipëria me infrastrukturë digjitale broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit”. Për realizimin e këtij vizioni, përcaktohen këto objektiva strategjike të zhvillimit të Broadband: **Objektivi strategjik 1:** Zhvillimi i qëndrueshëm i infrastrukturës Broadband **Objektivi strategjik 2:** Reduktimi i ndarjes digjitale dhe ofrimi i shërbimeve gjithëpërfshirëse Broadband **Objektivi strategjik 3:** Rritje e kërkesës për zhvillimin e ekonomisë digjitale dhe një shoqëri Gigabit. Projektligji synon pikërisht që të mundësojë arritjen e objektivit strategjik për një shoqëri gigabit përmes mundësimit të zhvillimit të rrjeteve me kapacitet shumë të lartë. .

Problemi në shqyrtim

- *Përshkruani natyrën e problemit.*
- *Identifikoni shkaqet e problemit.*
- *Përshkruani shtrirjen e problemit.*
- *Identifikoni grupet e prekura nga ky problem - qeveria / biznesi / shoqëria civile / qytetarët.*
- *Vlerësoni nëse problemi mund të trajtohet ose jo përmes një ndryshimi të politikave.*

Tregu i telekomunikacioneve është një treg i liberalizuar dhe i hapur për konkurrencë nga viti 2008. Investimet që kryhen në këtë sektor janë kryesisht nga sektori privat. Rrjetet e telekomunikacionit/komunikimeve elektronike dhe lidhja në internet me kapacitet shumë të lartë përbejnë sot një infrastrukturë kyçe për komunikimin e të dhënave dhe për mbështetjen e të gjithë zhvillimit të ekonomisë digjitale si për sektorin publik ashtu dhe atë privat. Në tregun e telekomunikacioneve operojnë një numër i madh kompanish për ofrimin e shërbimeve të Internetit, telefonisë, komunikim të dhënash. Numri i përdoruesve të internetit broadband është rritur vit pas viti. Pavarësisht kësaj, penetrimi i internetit fiks Broadband është ende i ulët në Shqipëri, me 559,830 abonentë të lidhur në vitin 2021, një rritje prej 10% krahasuar me vitin 2020. Në vitin 2021, shkalla e penetrimit të aksesit Broadband në rrjetet fikse u vlerësua në mbi 77% për familje dhe rreth 20% në nivel popullsisë, duke shënuar një rritje të ndjeshme përkatësisht 7% dhe 2%, në një periudhë dymbëdhjetëmuajore. Pjesa e abonentëve që përdorin internetin nga rrjeti fiks me shpejtësi më shumë se 10 Mbps ka arritur në 83%, krahasuar me rreth 67% në vitin 2020. Për shpejtësinë e Broadband, më të madh se 100 Mbps, abonimet rriten nga rreth 15,406 abonentë në 2020 në 55,065 në 2021. Numri i abonentëve me shpejtësi të lidhjes Broadband 1 Gbps ose më shumë, është pesëfishuar në krahasim me vitin 2020. Zonat rurale përbëjnë 40% të popullsisë, por vetëm 3.7% janë të lidhura me internetin. Shkalla e penetrimit të celularëve në fund të vitit 2020 ishte 70% krahasuar me 61,8% në fund të 2019. Në vitin 2020, kishte 2 milionë përdorues aktivë të Broadband celular. Vëllimi i përdorimit të të dhënave gjatë vitit 2020 është rritur me 29,4% krahasuar me vitin 2019 ndërsa në vitin 2021, vëllimi i të dhënave të transmetuara nëpërmjet internetit në rrjetet celulare ka arritur në rreth 155 milionë GB, që është një rritje prej rreth 74,9% krahasuar me vitin 2020. Si rezultat, konsumi mesatar mujor i internetit për abonentët është rritur me rreth 64%, duke arritur në rreth 6.39 GB në muaj. Në tregun e shërbimeve celulare gjatë vitit 2021, operatorët kanë raportuar një xhiro prej 24.5 miliardë lekësh, që është një rritje prej 3% krahasuar me vitin 2020, duke investuar më shumë se 4.6 miliardë lekë. Përafërsisht 82% e vlerës së investimeve të raportuara shkoi për përmirësimin e infrastrukturës së ofrimit me Broadband të rrjeteve celulare, gjë që reflektohet edhe në përmirësimin e mbulimit të rrjeteve 3 dhe 4G, si rezultat i volumit të internetit të konsumuar. Megjithatë, investime të reja të rëndësishme në rrjetet dhe shërbimet 5G mund të parashikohen në vitet në vijim. Është e qartë se kuadri ekzistues në Shqipëri ka shfaqur më shumë konkurrencë, çmime dhe zgjedhje më të mira për konsumatorët dhe nxiti operatorët që të upgrade rrjetet e tyre të paktën në disa zona. Sot shumica e familjeve kanë akses në Broadband bazik dhe ka një numër në rritje të atyre që kanë akses në lidhje me shpejtësi më të madhe. Në mungesë të

infrastrukturave kabllore televizive, eksperiencat nga BE-ja, kanë treguar se duhen marrë masa për stimulimin e investimeve në infrastrukturat alternative për përshpejtimin e investimeve të infrastrukturës Broadband në treg. Nevoja për nxitjen e investimeve në infrastrukturat me kapacitete shumë të larta kërkojnë dhe adoptimin e politikave të reja. .

Arsyeja e ndërhyrjes

- *Shpjegoni pse qeveria e sheh të nevojshme të ndërhyjë.*
- *Shpjegoni se çfarë shpreson të trajtojë qeveria nëpërmjet kësaj ndërhyrjeje.*
- *Shpjegoni se si i mbështet kjo ndërhyrje objektivat e nivelit të lartë të qeverisë.*
- *Rendisni punën ekzistuese që është realizuar tashmë.*

Qëllimi i përgjithshëm i kësaj nisme është të kontribuojë në arritjen e synimit që Shqipëria të ketë një infrastrukturë digjitale broadband të shpejtësisë së lartë dhe shumë të lartë në gjithë vendin, për të ngritur themelet për një shoqëri Gigabit përmes krijimit të një kuadri ligjor e rregullator adekuat me ndryshimet e zhvillimet e vullshme në sektorin digjital dhe me qëllim adresimin e sfidave me të cilat përballë tregu sic jepet me poshte: Tregu i komunikimeve elektronike (telekomunikacioneve) përballë me një sërë sfidash: Shtrirja e rrjeteve fikse Broadband është shumë e ulët në zonat rurale dhe ekziston një hendek i ndarjes digjitale midis zonës urbane dhe rurale; Kërkesat për kapacitet të rrjeteve të telekomunikacionit për internet (si për rrjetet fikse ashtu edhe ato celulare), po rriten me shpejtësi; Këta faktorë kërkojnë më shumë investime të përshpejtuara, për të plotësuar këto nevoja dhe për të arritur objektivat e shoqërisë gigabit, ndërkohë që konkurrenca me Over the Top (OTT) rritet. Ka një numër të kufizuar operatorësh më të mëdhenj, të cilët po konsolidohen duke synuar operimin në një bazë më rajonale dhe duke ulur potencialisht ofertën në treg, gjë që mund të çojë në reduktim të ekonomisë të shkallës; Operatorët privatë kanë zhvilluar rrjetet mobile Broadband, në brezat 3G dhe 4G, por rrjetet 5G që janë të rëndësishme për zhvillimet e të ardhmes, nuk janë ende të pranishme; Ka një bashkëpërdorim të kufizuar të infrastrukturës ekzistuese dhe inxhinierisë civile si dhe proceset e lejeve të ndërtimit dhe sigurimi i drejtës së kalimit mund të jenë të vështira. Shqipëria që nga viti 2014, është një vend kandidat për në BE. Në vitin 2018, Komisioni nxorri një rekomandim të pakushtëzuar për hapjen e negociatave të anëtarësimit. Më 26 mars 2020, Këshilli Evropian miratoi vendimin e Këshillit për hapjen e negociatave të anëtarësimit me Shqipërinë. Në vijim të kësaj, Shqipëria ka vazhduar të harmonizojë legjislacionin e saj me kërkesat e BE-së në një sërë fushash, duke rritur aftësinë e saj për të marrë përsipër detyrimet e anëtarësimit. Në raportet e fundit të BE-së për Shqipërinë²⁰, rekomandohet të "vazhdohet puna për miratimin e ndryshimeve të nevojshme në Ligjin për Komunikimet Elektronike, në përputhje me Kodin e ri Evropian të Komunikimeve Elektronike dhe të miratohet plani i veprimtimit për agjendën digjitale". Kodi i ri Evropian i Komunikimeve Elektronike, përbën një reformë politike të rëndësishme për zhvillimin e rrjeteve me Kapacitet Shumë të Lartë (VHCN), si ato me fibër, ashtu edhe ato 5G. Zhvillimi i shpejtë i teknologjive digjitale dhe shfaqja e formave të reja të komunikimeve përmes rrjeteve të komunikimit elektronik/telekomunikacioneve, krijon mundësi por dhe sfida të reja në aspektet rregullatore, që duhen mbajtur parasysh në hartimin e politikave të reja. Kuadri rregullator, i bazuar në ligjin ekzistues nr. 9918 datë 19.5.2008 "Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, është ndërtuar sipas praktikës europiane mbi tre objektiva kryesore: promovimi i konkurrencës, i tregut të brendshëm dhe i interesave të përdoruesve fundorë (të cilësuar masivisht në termat e të drejtave ligjore: për shërbimin universal, privatësinë, mbrojtjen e përdoruesit fundor dhe të grupeve vulnerabël). Bazuar në këto objektiva kryesore, kuadri rregullator përcakton një sërë parimesh dytësore - të tilla si promovimi i parashikueshmërisë rregullatore, promovimi i investimeve efikase dhe inovacionit, duke rregulluar tregjet vetëm aty ku nuk ka konkurrencë efektive dhe të qëndrueshme - të cilat rregullatorët duhet t'i marrin parasysh kur ndjekin objektivat parësore. Tre objektivat kryesore aktuale si dhe parimet rregullatore në lidhje me investimet dhe inovacionin mbeten të vlefshme dhe të përshtatshme. Megjithatë, sektori i komunikimeve elektronike po gjeneron gjithnjë e më shumë ndikime ekonomike dhe socio-ekonomike në pjesën tjetër të ekonomisë, duke u bërë themeli i sistemeve moderne, novatore, ekonomike, si dhe i shërbimeve të caktuara shoqërore, si transporti elektronik, qeverisja elektronike, kujdesi elektronik

²⁰ Raporti i Shqipërisë 2020 SWD(2020) 354 Dokumenti përfundimtar i punës së stafit të Komisionit;

shëndetësor, dhe edukimi elektronik. Kjo mund të jetë e mundur vetëm nëse rrjetet e duhura ndërtohen në një shkallë të mjaftueshme dhe nëse lidhja përmes rrjeteve të shpejtësisë shumë të larta (VHC) bëhet e aksesueshme dhe e përballeshme nga të gjithë qytetarët dhe bizneset. Konektiviteti digjital, njihet si forca shtytëse themelore për shoqërinë dhe ekonominë digjitale, mbështetur nga ndryshimet teknologjike dhe kërkesat në zhvillim të konsumatorëve dhe të tregut. Paraqitet e nevojshme që objektivat aktuale të kuadrit rregullator ekzistues, duhet të shoqërohen nga një objektiv i ri i konektivitetit i gjendur në EECC, i përcaktuar si: Qasja dhe mundësimi i internetit me kapacitet shumë të lartë, si fiks ashtu edhe celular për të gjithë qytetarët dhe bizneset evropiane, si dhe shërbimet e komunikimit ndërpersonal, mbi bazën e çmimeve dhe zgjedhjeve të përballeshme, të mundësuar nga konkurrenca efektive dhe e ndershme, nga investimet efikase me kthime të përshtatshme, nga inovacioni, nga rregullat e përbashkëta dhe qasjet e parashikueshme rregullatore në tregun e brendshëm duke mbrojtur interesat e qytetarëve. Objektiv i ri sipas praktikës evropiane të EECC, do t'u shtohet objektivave tashmë ekzistuese, për promovimin e konkurrencës dhe interesave të qytetarëve. Këto duhet të konceptohen si një e tërë, në përputhje me strategjitë e politikave për koherencën e objektivave, në veçanti me strategjinë e konektivitetit, e cila kuptohet rreth tre grupeve të ambicieve specifike: a. Konektiviteti Gigabit për drejtuesit socio-ekonomikë b. Konektivitet celular i kudogjendur c. Përmirësimi i konektivitetit në zonat rurale. .

Objektivi i politikës

- *Vendosni objektiva që korrespondojnë me problemin dhe shkaqet e tij.*
- *Sigurohuni që objektivat e vendosur të korrespondojnë me ato të dhëna në përmbledhjen ekzekutive, por më të detajuara.*
- *Sigurohuni që objektivat janë specifike, të matshëm, të arritshëm, realë dhe në kohë.*

Objektivat e synuara që duhet të arrihen përmes kësaj politike mund të përmbliidhen si:

- a) Përsheptim i zhvillimit dhe investimit në infrastrukturën digjitale (përkatesisht rrjetet VHCN), për të adresuar kërkesën më të lartë për konektivitet digjital dhe shoqërinë gigabit me qëllim rritjen e penetrimit fiks broadband fiks me 30% brenda tre viteve te para;
- b) Harmonizimi me direktivën e BE-së për krijimin e Kodit Evropian të Komunikimeve Elektronike brenda vitit 2022.
- c) Reduktim i dallimeve në mbulimin urban/rural dhe sigurim i zbutjes së ndarjes digjitale; Ulja e kostos së shtrirjes së rrjetit, përmes bashkëpërdorimit të infrastrukturës passive, duke inkurajuar investimet në modelet konkurruese të biznesit;
- d) Harmonizim dhe koordinim i politikave të spektrit, për të siguruar akses në ekonominë e shkallës në Shqipëri;
- e) Zhvillim i politikave konkurruese të fuqishme dhe të orientuara drejt tregut, të cilat sigurojnë një ofertë të larmishme për konsumatorin dhe promovojnë investimet midis operatorëve;
- f) Masa harmonizuese në lidhje me të drejtat e konsumatorëve;
- g) Zgjerim i qëllimit të kuadrit rregullator, për të mbuluar disa shërbime të komunikimit ndërpersonal (të pavarura nga numri), të cilat më parë ishin të parregulluara.
- h) Legjislacioni shqiptar të jetë në përputhje me standardet dhe legjislacionin e BE-së, duke rritur kështu aftësinë e Shqipërisë për të marrë përsipër detyrimet e saj të anëtarësimit.

Konektiviteti digjital, njihet si forca shtytëse themelore për shoqërinë dhe ekonominë digjitale, mbështetur nga ndryshimet teknologjike dhe kërkesat në zhvillim të konsumatorëve dhe të tregut. Paraqitet e nevojshme që objektivat aktuale të kuadrit rregullator ekzistues, duhet të shoqërohen nga një objektiv i ri i konektivitetit i gjendur në EECC, i përcaktuar si: *Qasja dhe mundësimi i internetit me kapacitet shumë të lartë, si fiks ashtu edhe celular për të gjithë qytetarët dhe bizneset evropiane, si dhe shërbimet e komunikimit ndërpersonal, mbi bazën e çmimeve dhe zgjedhjeve të përballeshme, të mundësuar nga konkurrenca efektive dhe e ndershme, nga investimet efikase me kthime të përshtatshme, nga inovacioni, nga rregullat e përbashkëta dhe qasjet e parashikueshme rregullatore në tregun e brendshëm duke mbrojtur interesat e qytetarëve.*

Objektivi i ri sipas praktikës evropiane të EECC²¹, do t'u shtohet objektivave tashmë ekzistuese, për promovimin e konkurrencës dhe interesave të qytetarëve.

Këto duhet të konceptohen si një e tërë, në përputhje me strategjitë e politikave për koherencën e objektivave, në veçanti me strategjinë e konektivitetit, e cila kuptohet rreth tre grupeve të ambicieve specifike:

- a. Konektiviteti Gigabit për drejtuesit socio-ekonomikë
- b. Konektiviteti celular i kudogjendur
- c. Përmirësimi i konektivitetit në zonat rurale.

Përshkrimi i opsioneve të shqyrtuara

- *Përshkruani opsionin e status quo-së.*
- *Identifikoni dhe përshkruani të gjitha opsionet e politikave që keni marrë parasysh.*
- *Shpjegoni se si janë identifikuar opsionet e politikës.*
- Opsionet e mëposhtme janë vlerësuar në funksion të arritjes së objektivave të politikave:
 -
 - Opsioni 0: Status quo-ja, mos ndryshimi i gjendjes aktuale;
 - Opsioni 1: Derregullimi; ku shumica e rregullave hiqen përmes një amendimi të ligjit ekzistues;
 - Opsioni 2: VHCN; opsioni ku fokusi zhvendoset në sigurimin e investimeve në rrjetet VHCN – miratimi i një ligji të ri
- **Opsioni 0 . Baza; opsion ku nuk ndryshon asgjë dhe ruhet status quo-ja.**

Nuk ndërhyhet me ndryshime apo politikë të re, gjë që na çon në situatën ku mbeten problematikat aktuale. Ndikimet ekonomike të këtij opsioni përfshijnë/ndikojnë veçanërisht në boshllëqet e dukshme në aftësitë e rrjeteve të komunikimit elektronik (konektiviteti digjital me shpejtësi të lartë), që ndikojnë në ofrimin e shërbimeve tek familjet dhe bizneset që lidhen me aplikacione të tilla si “clouds computing” si dhe në marrjen e shërbimeve të tjera që kërkojnë lidhje me gjerësi bande të lartë dhe/ose simetrike (të tilla si televizioni i gjeneratës së ardhshme, video-konferencat, edukimi, e-health dhe aplikacionet e monitorimit në distancë).

Nga ana tjetër, lidhjet e dobëta në konektivitetin brenda vendit, mund të kenë ndikime më të gjera në atraktivitetin e Shqipërisë si një qendër për inovacionin dhe zhvillimin e biznesit në TIK. Në këtë kontekst, duhet mbajtur parasysh që kanë industri të mirëzhvilluara të TIK-ut, janë mbështetur nga nxitja e hershme e investimeve për lidhje/konektivitet me shpejtësi shumë të lartë²².

Gjithashtu një studim i përgatitur për Komisionin e BE-së në vitin 2015²³, duke përdorur analizën ekonometrike dhe modelimin makro-ekonomik, vlerëson se arritja e shpejtësive mesatare të pritshme në një skenar të plotë me fibra, deri në vitin 2025, do të rriste PBB-në evropiane me 2% krahasuar me status quo-në dhe me 0.7% në një skenar në rritje me shpejtësi të lartë.

²¹ Direktiva 2018/1972/EU <https://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/?uri=CELEX%3A32018L1972>

²² Për shembull, në Japoni, ku broadband me mbulim shumë të shpejtë kishte arritur në 90% deri në vitin 2012, tregu i TIK-ut përbënte rreth 8.9% të të gjitha industrive dhe 7.1% të punësimit total. Në të kundërt, mbulimi i BE-së në BE ishte rreth 53%, punësimi i TIK-ut në BE përfaqësonte vetëm 4% të PBB-së dhe 2.7% të punësimit total në BE në 2011

²³ WIK 2015, Mbështetje për përgatitjen e vlerësimit të ndikimit që shoqëron rishikimin e kuartrit rregullator për komunikimet elektronike (SMART 2015/0005), Studim për Komisionin Evropian (2015-2016) 23 Relevant market – shiko percaktimet në ligjin 9918 date 19.5.2008 për komunikimet elektronike në RSH.

Rrjetet celulare 4G dhe ato 5G varen nga "fiber backhaul" për të përmbushur kërkesat për "vonesën e ulët/low latency" të nevojshme për aplikacione të tilla si telemjekësia, apo aplikacione të tjera që kërkojnë cilësi të lartë shërbimi.

Mungesa e ndërmarrjes së veprimeve për përsheptimin e zhvillimit dhe investimeve në infrastrukturën digjitale (përkatësisht rrjetet VHCN), për të adresuar kërkesën më të lartë për konektivitet digjital dhe shoqërinë gigabit, do të kishte implikime negative si për aplikacionet në celular, ashtu dhe ato dhe fikse.

Ndikimi ekonomik i këtij opsioni mund të shoqërohet me koston oportune të dështimit, duke penguar vendosjen e infrastrukturës së nevojshme, për të përdorur gjerësisht shërbimet e avancuara, duke përfshirë 5G-në.

Të ardhurat nga komunikimet elektronike të raportuara nga ofruesit e shërbimeve nga rrjetet fikse për vitin 2021, kaluan vlerën e 10.9 miliardë lekëve. Kjo paraqet një rritje prej rreth 15% krahasuar me vitin 2020 megjithatë është e pamjaftueshme për të adresuar nevojat në rritje për kapacitete të larta dhe shume të larta.

Vëllimi i përdorimit të të dhënave gjatë vitit 2020 është rritur me 29,4% krahasuar me vitin 2019 ndërsa në vitin 2021, vëllimi i të dhënave të transmetuara nëpërmjet internetit në rrjetet celulare ka arritur në rreth 155 milionë GB, që është një rritje prej rreth 74,9% krahasuar me vitin 2020. Si rezultat, konsumi mesatar mujor i internetit për abonentët është rritur me rreth 64%, duke arritur në rreth 6.39 GB në muaj.

Në tregun e shërbimeve celulare gjatë vitit 2021, operatorët kanë raportuar një xhiro prej 24.5 miliardë lekësh, që është një rritje prej 3% krahasuar me vitin 2020.

Përafërsisht 82% e vlerës së investimeve të raportuara shkoi për përmirësimin e infrastrukturës së ofrimit me Broadband të rrjeteve celulare, gjë që reflektohet edhe në përmirësimin e mbulimit të rrjeteve 3 dhe 4G, si rezultat i volumit të internetit të konsumuar. Megjithatë, investime të reja të rëndësishme në rrjetet dhe shërbimet 5G mund të parashikohen në vitet në vijim, por ende rrjetet 5G nuk janë prezent.

Është e qartë se kuadri ekzistues në Shqipëri ka shfaqur më shumë konkurrencë, çmime dhe zgjedhje më të mira për konsumatorët dhe nxiti operatorët që të upgrade rrjetet e tyre të paktën në disa zona. Sot shumica e familjeve kanë akses në Broadband bazik dhe ka një numër në rritje të atyre që kanë akses në lidhje me shpejtësi më të madhe. Në mungesë të infrastrukturave kablore televizive, eksperiencat nga BE-ja, kanë treguar se duhen marrë masa për stimulimin e investimeve në infrastrukturat alternative për përsheptimin e investimeve të infrastrukturës Broadband në treg.

Në BE dhe gjetkë, një zhvillim i rëndësishëm në vitet e fundit, është se rrjetet e vjetra telefonike dhe kablore (koaksiale), duke përfshirë 'qarqet locale lookal loops' të bakrit, janë në proces të përmirësimit me fibra dhe zgjidhje të tjera që përmirësojnë performancën Broadband. Për sa i përket kërkesës, këto përmirësime nevojiten për t'u mundësuar klientëve që të gëzojnë cilësi më të mirë në shërbimet në internet, duke përfshirë videot në internet dhe aplikacionet Cloud, si dhe të mundësojnë shikimin me shumë ekrane, gjë që po bëhet gjithnjë e më popullore. Siç u theksua, tashmë vëllimi i përdorimit të të dhënave në Shqipëri gjatë vitit 2020 u rrit me 29,4% krahasuar me vitin 2019. Në Shqipëri, teknologjia kryesore për ofrimin e rrjetit fiks Broadband është FTTH/FTTB, e ndjekur nga lidhjet DSL që bazohen në rrjetet e kombinuara bakër dhe fibër optike (FTTN/FTTC). Kalimi nga bakri në fibër po përsheptohet.

Sipas raportit të fundit të BE-së për Shqipërinë, ndonëse zonat rurale përbëjnë 40% të popullsisë, vetëm 3.7% janë të lidhura me internetin. Kjo tregon për një ndarje të konsiderueshme digjitale në Shqipëri.

Promovimi i interesave të përdoruesve fundorë, duke përfshirë dispozitat për një rrjet të sigurtë nëpërmjet detyrimeve të shërbimit universal, është një objektiv kryesor i kuadrit rregullator, pasi siguron që konsumatorët mund të marrin pjesë në shoqërinë digjitale dhe të përfitojnë plotësisht benefitet e një tregu konkurrues. Në përgjithësi, legjislacioni shqiptar ka qenë i suksesshëm në mbrojtjen konsumatorit, edhe kur kjo nuk përket plotësisht në rritje të kënaqësisë së konsumatorit.²⁴ Duke pasur parasysh rolin në rritje të konektivitetit dhe shërbimeve të komunikimeve elektronike në ekonominë e sotme evropiane, është e rëndësishme të vazhdohet të mbrohet interesi i përdoruesve fundorë.

Rregullat kombëtare kanë siguruar transparencën e informacionit mbi shërbimet dhe çmimet nga ofruesit; Rregullat për kohëzgjatjen e kontratës²⁵ janë transpozuar në mënyrë që periudha fillestare e angazhimit të mos kalojë 24 muaj, duke siguruar gjithashtu që ofruesit t'u ofrojnë përdoruesve mundësinë për të nënshkruar një kontratë me një kohëzgjatje maksimale prej 12 muajsh. Pavarësisht sa më sipër, konsumatorët ende i referohen çështjeve që lidhen me transparencën dhe cilësinë e shërbimit, ndërhyrjen dhe transportueshmërinë e numrave. Problemet mund të jenë veçanërisht të mprehta kur qasja në shërbimin e internetit është e lidhur me shërbime të tjera të komunikimit, duke rezultuar që konsumatorët të mos e kenë të lehtë të krahasojnë çmimet e paketave. Evidencat nga Evropa tregojnë se një numër në rritje i konsumatorëve në shumicën e Shteteve Anëtare zgjedhin këtë mënyrë të ofrimit të shërbimit, ku shërbime të shumta janë të bashkuara në një ofertë konsumatore. Kjo prirje është e vërtetë edhe në Shqipëri²⁶ dhe nuk do të ndryshonte në një skenar status quo-je dhe perceptimet e konsumatorëve për problemet e transparencës dhe cilësisë së shërbimit ka të ngjarë të përkeqësohen për shkak të marrjes më të madhe të paketave, në një skenar bazë.

Efektiviteti i rregullave ka evoluar, pasi shikuesit përdorin gjithnjë e më shumë shërbimet e internetit (OTT) në televizorë inteligjentë dhe smartfonë/tableta dhe kanalet tradicionale televizive përfaqësojnë një pjesë në rënie (ndonëse ende dominuese), të modeleve të konsumit audio-vizual. Vetëm ofruesit e shërbimeve tradicionale të komunikimit duhet të respektojnë rregullat specifike të sektorit, që mbrojnë interesat e përdoruesve fundorë. Ofruesit e shërbimeve të komunikimit OTT, nuk u nënshtrohen këtyre të drejtave dhe detyrimeve specifike për sektorin, edhe kur shërbimet e tyre përdoren nga përdoruesit fundorë për të mbuluar nevojat e njëjta ose të ngjashme, sic janë shërbimet tradicionale të komunikimeve elektronike.

Në përgjithësi, mund të thuhet se një skenar që nuk paraqet ndryshime, do të çonte në një ndarje digjitale të vazhdueshme për qytetarët dhe NVM-të, rezultate jo të mira të zhvillimit ekonomik, shpërndarje jo optimale të kapitalit, mungesë besimi të konsumatorëve në shërbimet digjitale, pakësim të inovacionit dhe humbje të konkurrencës në industrinë e BE-së, si dhe mungesë të angazhimit drejt integritimit në BE.

Opsioni 1 . Rregullim më i lehtë, ku shumica e rregullimeve ekonomike hiqet duke u mbështetur në rregullimin simetrik

Ky opsion parashikon një reduktim të ndjeshëm të shtrirjes së rregullimit të aksesit për sektorin specifik, nëpërmjet një klauzole për rregullimin ex ante, të paktën në zonat ku janë të pranishme dy ose më shumë infrastruktura, duke kaluar kështu nga rregullimi specifik ex ante për komunikimet elektronike, në një

²⁴ Shyle, I. dhe Xhelo, E., 2017. Kënaqësia e klientit në industrinë e shërbimeve-rast studimi i industrisë së telekomunikacionit në Shqipëri. Në Konferencën e Parë Ndërkombëtare, Procedurat e Inxhinierisë dhe Sipërmarrjes.

²⁵ Neni 99, i ligjit 9918/2008 për komunikimet elektronike.

²⁶ Për shembull, raporti vjetor i AKEP-it 2020 thekson se "Ofrimi i shërbimeve të rrjetit fiks në paketat e aksesit të internetit të paketuara, duke përfshirë telefoninë fiksë dhe kanalet televizive (CaTV ose IPTV), është forma mbizotëruese e konkurrencës midis ofruesve të rrjeteve fiksë. Numri i abonentëve të rrjetit fiks që kanë akses në shërbimet duo dhe të paketuara të trefishta (kombinimi telefoni/internet/TV) në fund të vitit 2020 ishte rreth 292,000 ose 9% më shumë se në vitin 2019.

përcaktim ku NRA-të do të mbikëqyrnin tregun vetëm sipas nevojës, dhe sektori i komunikimeve elektronike do t'i nënshtrohej kontrollit ex post të ligjit të konkurrencës.

Sipas këtij opsioni, do të mbetet ende një rol i kufizuar për AKEP.. Preferenca do t'u jepej marrëveshjeve të negociuara komercialisht ndërmjet ofruesve të aksesit dhe kërkuesve të aksesit, pa pasur nevojë për të kryer analiza të rregullta të tregut dhe për të miratuar paraprakisht oferta referencë, siç është rasti në kuadrin aktual. Megjithatë, do të mbetet mundësia që NRA-të, të ndërhyjnë për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve, potencialisht nëpër segmente të tregut dhe zona gjeografike, por veçanërisht aty ku është e pranishme vetëm një infrastrukturë Broadband-i.

Kompetencat e NRA-ve do të përfshinin mundësinë e porositjes së furnizimit të shërbimeve me shumicë, por kjo do të ishte në formën e një produkti të vetëm aksesit, që synon të zgjidhë problemin specifik të aksesit të identifikuar në mosmarrëveshje. Proçesi i analizës së tregut²⁷ nuk do të ishte më i nevojshëm dhe mund të tërhiqej. Tërheqja me faza e proçesit të analizës së tregut sipas këtij opsioni, do të nënkuptonte gjithashtu një reduktim të kompetencës për MIE.

Opsioni 1 synon të adresojë problemet e identifikuar duke kufizuar fushëveprimin e rregullimit të aksesit mbi bazën se rregullimi i aksesit mund të dëmtojë vendosjen e rrjeteve VHC dhe mund të mos i çojë hyrjet në *'ngjitje të shkallëve të investimit'*. Një strategji e mandatimit të lehtësimit të rregullimit ex ante përpara se të kaloni në ligjin e konkurrencës, do të ishte në përputhje me këtë qëllim. Megjithatë, rastet studimore si dhe analizat sasiore të kryera nga Komisioni i BE-së, hedhin disa dyshime nëse kjo qasje do të adresonte në praktikë problemet e identifikuar.

Sipas kësaj strategjie, ekziston një rrezik i lartë që konkurrenca në infrastrukturë mund të mos shfaqet, ndërsa konkurrenca e bazuar në shërbime mund të zvogëlohet. Tregu amerikan kishte miratuar një qasje rregullatore me prekje të lehtë nga viti 2004 dhe Tom Wheeler, atëherë Kryetar i Autoritetit të Telekomit të SHBA, FCC, vuri në dukje në një fjalim të vitit 2014 se shumica e amerikanëve nuk kishin një zgjedhje konkurruese të ofertave mbi 25 Mbit/s²⁸.

Ndërkohë që masat minimale horizontale për aksesin në kanalet sipas Direktivës për Reduktimin e Kostos së Broadband²⁹, e cila u përafraua në kuadrin ligjor shqiptar me Ligjin 120/2016 *"për vendosjen e rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë dhe për sigurimin e të drejtës së kalimit"*, do të zbatoheshin ende në Shqipëri, këto do të mbështeteshin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe detyrimet e aksesit nuk mund të rregulloheshin aq fort sa ato të prezantuar për operatorët SMP, sipas kuadrin aktual për komunikimet elektronike.

Një strategji e zgjidhjes së mosmarrëveshjeve sipas legjislacionit ex ante të komunikimeve elektronike u ndoq në Zelandën e Re në periudhën nga viti 2000, por u ndërpre për shkak se ajo çoi në përdorim të ulët dhe çmime të larta për Broadband. Shembulli i Zelandës së Re, i përdorimit të proçeseve të udhëhequra nga zgjidhja e mosmarrëveshjeve sipas legjislacionit sektorial ex ante, sugjeron se ky është një mjet joefikas për të mundësuar konkurrencën. Është e dukshme që kjo qasje mund të ketë kontribuar në çmime të larta dhe në përdorim të ulët për Broadband në Zelandën e Re, në fazën e hershme të shtrirjes së rrjetit, krahasuar me vende të tilla si ato në Evropë, Japoni dhe fillimisht SHBA, të cilat ndoqën politikat e ndarjes³⁰. Në terma politikë, miratimi i strategjisë të Zelandës së Re në Shqipëri, mund të zvogëlojë konkurrencën me ndikime të dëmshme në mirëqenien e konsumatorit dhe përdorimin e Broadband-it (ky është një shqetësim i veçantë duke pasur parasysh mungesën e rrjetit televiziv kabllor në Shqipëri, i cili zbuti ndikimin në disa vende cituar në studim.

²⁷ Nenet 31-35 të ligjit 9918/2016

²⁸ <https://arstechnica.com/information-technology/2014/09/most-of-the-us-has-no-broadband-competition-at-25mbps-fcc-chair-says/>

²⁹ Direktiva 2014/61/BE 15 maj 2014 mbi masat për të ulur koston e vendosjes së rrjeteve të komunikimeve elektronike me shpejtësi të lartë

³⁰ Shtator 2016 - Regjimet rregullative, në shërbimet e aksesit, për investimet e investimeve në rrjet në Evropë - Një studim i përgjithshëm për Rrjetet, Përbajja dhe Teknologjia e Komunikimit të DG të Komisionit Evropian nga WIK, Deloitte dhe IDATE. ISBN 978-92-79-61823-9

Është e mundur që një qasje e lehtë që rezulton në konsolidim mund t'u mundësojë operatorëve të rrisin çmimet dhe të ardhurat, dhe në të vërtetë tarifën e Broadband-it. Në SHBA, ku ndiqet një qasje e lehtë për rregullimin e aksesit, çmimet janë përgjithësisht të larta në krahasim me ato në Evropë. Ndërsa çmimet më të larta në teori duhet të rrisin aftësinë e operatorëve për të investuar, kjo nuk do të thotë domosdoshmërisht se ata do të investojnë. Siç u diskutua më sipër, atyre mund t'u mungojë nxitja për të investuar nëse kjo strategji nuk arrin të nxisë më tej konkurrencën e bazuar në infrastrukturë të përçarë, e cila është identifikuar qartë në shumë studime si një nxitës kryesor i investimeve.

Ndërsa çmimet më të larta dhe ARPU-të mund të gjenerojnë stimuj për aktorët e rinj³¹ për të hyrë në treg, shkalla në nivelin e hyrjes në treg mund të jetë e vështirë.

Prandaj, në përgjithësi, arrijmë në përfundimin, se kjo strategji nuk ka gjasa të jetë efektive në përmbushjen e objektivave të deklaruara për sigurimin e një konektiviteti të përballueshëm të kudondodhur për të gjithë qytetarët në Evropë, si dhe ofrimin e shërbimeve ndërkufitare të biznesit. Një qasje e bazuar në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe jo në rregullimin ex ante të tregut, ka të ngjarë të jetë veçanërisht e pafavorshme për operatorët, të cilët mund të mos kenë ndikim të madh në asnjë treg të vetëm, por kërkojnë t'u shërbejnë klientëve nëpër rajone dhe vende të shumta në të gjithë BE-në. Mund të rezultojë në një prioritet të mjeteve juridike të tregut masiv në dëm të shërbimeve të shitjes me shumicë të krijuara për tregun e biznesit.

Opsioni 2. VHCN; opsioni ku fokusi zhvendoset në sigurimin e investimeve në rrjetet VHCN

Një shoqëri Gigabit duhet të ndërtohet mbi rrjete dhe shërbime të besueshme me shpejtësi të lartë, të përballueshme, që mbrojnë të drejtat themelore të konsumatorëve për privatësinë dhe mbrojtjen e të dhënave personale, duke inkurajuar gjithashtu inovacionin. Qasja duhet nëpërmjet veprimeve të përbashkëta, të sjellë përfitime për përdoruesit fundorë (qytetarët dhe bizneset), si dhe të promovojë lidhjen me performancë të lartë duke nxitur zhvillimin socio-ekonomik të Shqipërisë dhe industrisë së saj të komunikimit. Plani Kombëtar Shqiptar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025, vuri në dukje se situata e përgjithshme e zhvillimit të Broadband, në veçanti rrjetet fikse dhe ndarja e theksuar digjitale midis zonave urbane dhe rurale, tregon nevojën e lartë për investime të konsiderueshme në zhvillimin e infrastrukturës Broadband dhe se investimi vetëm nga sektori privat në zhvillimin e rrjetit, veçanërisht në zonat rurale dhe të largëta është i pamjaftueshëm.

Ndërkohë, nisma e BE-së, *Digjitalizimi i Industrisë Evropiane*³², vendos një lidhje të qartë midis konektivitetit dhe nevojës për të siguruar që Shtetet Anëtare të Evropës janë gati për sfidat e reja të produkteve dhe shërbimeve digjitale në fusha të tilla si: 5G, cloud computing, IoT, teknologjitë e të dhënave dhe siguria kibernetike.

Të gjitha rrjetet me fibra, duket se janë në një pozicion më të mirë për të përballuar këto sfida, sesa rrjetet e tjera bakër. Nga ana tjetër, IoT luan një rol të rëndësishëm në përmirësimin e shërbimeve në industrinë e ndryshme, përfshirë automobilat, bujqësinë, shëndetin dhe transportin. Kështu, politikat që zhblokojnë potencialin e plotë të IoT dhe digjitalizimin e industrisë nxisin një shteg rritjeje shkatërruese pengesë të zhvillimit³³.

Rishikimi i kuadrit të komunikimeve elektronike që mbështet disponueshmërinë e rrjeteve VHC është për këtë arsye plotësues i nismës *“Digjitalizimit të Industrisë Evropiane”*, pasi nxit zhvillimin e shërbimeve me vlerë të shtuar në Shqipëri që do të mbështeteshin në rrjete, ndërkohë që mos disponueshmëria e lidhjes VHC detyron ofruesit për të përshtatur shërbimet ose për t'i drejtuar ato diku tjetër.

³¹ SMART 2015/0002, WIK (2015) konkurrenca dhe investimi, EP (2013) "Si të ndërtohet një shoqëri dixhitale e kudondodhur".

³² Shiko : <https://ec.europa.eu/digital-single-market/en/digitising-european-industry>

³³ "Teknologjitë e Informacionit dhe Çrregullimet e Tregut të Punës - Një Dialog Ndër-Atlantik" nga "Tryeza ndërdisiplinore, ndërsektoriale e organizuar nga Komisioni Evropian (DG Enterprise and Industry dhe DG Communication Networks, Content and Technology) në bashkëpunim me Bordin e Konferencës dhe Cornell University ILR School" 3/11/2014, f. 11

Në BE, komunikimet elektronike janë një sektor strategjik, i cili kontribuon drejtpërdrejt me 168.62 miliardë euro vlerë të shtuar evropiane dhe 1.06 milionë vende pune (rreth 1.3% të PBB-së dhe 0.47% të punësimit total në 2012), me një produktivitet të punës për person më shumë se 144 mijë euro (shkalla më e lartë është në sektorin e TIK-ut), sipas një studimi të JRC³⁴. Sektori mbështet një gamë të gjerë shërbimesh të tjera të prodhimit të teknologjisë së lartë dhe digjitale (sektori i TIK-ut përbën 4% të PBB-së dhe 2,76% të vendeve të punës në BE, me një normë produktiviteti të punës 44,45% më e lartë se produktiviteti total i punës), si dhe mbështet ekonominë në tërësi. Vlerësimet në Shqipëri janë gjerësisht në përputhje me ato të BE-së, me TIK-un dhe komunikimet elektronike që luajnë një rol po aq të rëndësishëm në Shqipëri, me vlerësimin në vitin 2017 prej 3% të kontributit të sektorit TIK në PBB³⁵.

Rreziku është se ritmi aktual i shtrirjes së infrastrukturës mund të rezultojë në vitet e ardhshme në konektivitet të kufizuar duke ndikuar negativisht në kapacitetin e qytetarëve, bizneseve dhe autoriteteve publike për të prodhuar, ndarë dhe përfituar nga produktet dhe shërbimet digjitale inovative. Ndërsa rrjetet e komunikimit elektronik bëhen infrastruktura gjithnjë e më kritike, aktorët e tregut duhet të jenë në gjendje të zgjerohen, duke grumbulluar dhe rritur kërkesën ekzistuese dhe nëpërmjet këtij potenciali drejt një shoqërie gigabit. Ndërsa tregjet me shumicë për akses në rrjete, për arsye të mungesës së zëvendësimit dhe lokalitetit të ofrimit të shërbimit, do të mbeten shpesh ose lokale, rajonale ose në rastin më të mirë kombëtare, ofruesit e tjerë të shërbimeve të komunikimit nuk duhet t'u nënshtrohen barrierave ndërkufitare për integrimin e mëtejshëm të tregut.

Mungesa e konektivitetit të kudogjendur VHC pengon tregun të përdorë një pjesë të konsiderueshme të kapitalit të tij njerëzor, ndikon në kohezionin territorial dhe ka një ndikim negativ në aftësinë e bizneseve për të prodhuar me efikasitet dhe për të ofruar shërbime inovative dhe konkurruese. Konektiviteti mund të luajë një rol thelbësor socio-ekonomik për të parandaluar izolimin dhe shpopullimin, dhe për të lidhur rajonet periferike me rajonet qendrore. Lidhja efektive mund të zvogëlojë kostot e ofrimit të mallrave dhe shërbimeve, publike dhe private, dhe pjesërisht të kompensojë largësinë, duke siguruar pjesëmarrjen e njerëzve dhe bizneseve në këto zona në ekonominë e digjitalizuar. Për më tepër, lidhja është një mundësi që jo vetëm sipërmarrjet shqiptare të konkurrojnë me pjesë të tjera të globit, por edhe për shërbimet publike, përfshirë shkollat, për të ofruar shërbime të klasit të parë për qytetarët shqiptarë.

Për më tepër, ndërsa shërbimet thelbësore si bankat dhe ndërveprimet me qeveritë vendore dhe kombëtare, përdorin internet, si p.sh. me shërbimet online të Qeverisë E Government që ofrohen në One stop Shops, brenda ambienteve të bashkive shqiptare në të gjithë vendin, konektiviteti është jetik për përfshirjen sociale dhe ekonomike dhe futja e 5G do ta nxisë më tej këtë rol të tij. Përveç tejkalimit të boshllëqeve aktuale në mbrojtjen e përdoruesit fundor në fusha të caktuara si siguria dhe dhe arritja e rezultateve efektive për konsumatorët, qasjet konsistente ndaj rregullimit të komunikimeve elektronike brenda tregut të vetëm (duke përfshirë mekanizmat për të siguruar konkurrencë efektive), janë të rëndësishme për të siguruar një fushë loje të barabartë midis operatorëve dhe për të shmangur arbitrazhin ku 'kampionët kombëtarë' mund të mbrohen brenda tregut e tyre vendas dhe të shfrytëzojnë avantazhe të tilla kur hyjnë në tregjet fqinje.

Për të adresuar mospërputhjet në tregjet që kanë një aspekt të qartë ndërkufitar, nevojitet veprim. Një rast i tillë është aksesit i biznesit, ku standardizimi i karakteristikave të produktit dhe niveleve të shërbimit është i rëndësishëm në mbështetjen e ofrimit të shërbimeve pa probleme për korporatat në tregje të shumta evropiane. Në këto raste, rregullimi i qëndrueshëm i aksesit dhe rregullat e mbrojtjes së përdoruesit fundor, ndaj atyre që mbizotërojnë në vendet e Bashkimit Evropian, heq rrezikun e barrierave ligjore për Shqipërinë duke bërë të mundur ofrimin dhe marrjen pjesë në oferta të shërbimeve shumëterritoriale.

Në Planin Kombëtar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale, Broadband 2020-2025 (PKB), ekziston një njohje e përgjithshme e rëndësisë së konektivitetit si një objektiv rregullator dhe

³⁴ Raporti i JRC-së "RAPORTI I PARASHIKIMIT 2015 Një Analizë e Kërimit dhe Zhvillimit të TIK-ut në BE dhe më gjerë" ISBN 978-92-79-52698-5

³⁵ <https://www.infrastruktura.gov.al/National-Plan-BBAnd-EN.pdf>

nevojës për të krijuar kushte të duhura për stimulimin e mundësive të reja të biznesit, duke koordinuar më mirë caktimin e spektrit. Nevojiten gjithashtu masa, për të trajtuar shkaqet themelore të problemit, duke i mundësuar çdo operatori, pavarësisht nga madhësia apo fushëveprimi i tij, të përfitojë nga procedurat e harmonizuara, nga rregullimi i qëndrueshëm dhe konsistent që lejon vlerësime të besueshme për kthimin e kapitalit të investuar në rrjete të zgjeruara. Masa të tilla do të sigurojnë parashikimet rregullatore dhe sigurinë ligjore të nevojshme për të ndërmarrë investime në rrjetet Broadband dhe për të kapërcyer ndarjen digjitale, duke lejuar kështu konsumatorët të gëzojnë shërbime të reja.

Objektivi është të adresohet mbulimi i ulët dhe përdorimi i kufizuar i lidhjeve me kapacitet shumë të lartë dhe arsyet për investime jo optimale në Shqipëri. Prandaj, hapja e rrjetit VHC duhet të nxitet duke vënë theksin tek rritja e konkurrencës në infrastrukturë, kur është e mundur, bashkëinvestimi, modelet e infrastrukturës (vetëm me shumicë), tek masat për uljen e kostos në bazë të kthimit adekuat të investimit.

Kjo mund të arrihet duke:

- Adresuar nevojat e biznesit në drejtim të lidhjes ndërkufitare;
- Siguruar stimuj të mjaftueshëm për operatorët për të shtrirë infrastrukturën VHC (ku konkurrenca në infrastrukturë është e pamjaftueshme), një aspekt tjetër është t'u ofrohet siguri më e madhe atyre që angazhohen të investojnë në zona sfiduese;
- T'i jepet kohë tregut për burimet e spektrit, në mënyrë që spektri të vihet shpejt në dispozicion të teknologjisë së gjeneratës së ardhshme 5G, me kushte që favorizojnë investimet dhe parashikueshmërinë;
- Modernizimi i Operatorëve të Shërbimit Universalë për tu pershtatur me zhvillimet e tregut dhe zhvillimet teknologjike, dhe për ta sjellë atë në përputhje me nevojat aktuale të qytetarëve.

Vlerësimi i opsioneve/analizimi i ndikimeve

- *Identifikoni grupet e prekura.*
- *Identifikoni llojet e ndikimeve për secilin grup të prekur, bëni dallimin midis ndikimeve të drejtpërdrejta dhe jo të drejtpërdrejta.*
- *Për ndikimet e drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet e drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni nga ana sasiore ndikimet më të rëndësishme të drejtpërdrejta.*
 - *Përcaktoni vlerën monetare të ndikimeve më të rëndësishme të drejtpërdrejta aty ku është e mundur (përdor tabelën në Aneksin 2/a të këtij dokumenti).*
 - *Analizoni ndikimin mbi ndërmarrjet e vogla dhe të mesme (nëse ka).*
- *Për ndikimet jo të drejtpërdrejta:*
 - *Përshkruani nga ana cilësore ndikimet jo të drejtpërdrejta mbi grupet e prekura.*
 - *Analizoni ndikimin mbi konkurrencën.*
- *Diskutoni kufizimin e analizës:*
 - *Jepni supozimet në të cilat janë bazuar parashikimet dhe risqet, të cilave ato u nënshtrohen.*
 - *Tregoni se çfarë mund të pengojë realizimin e përfitimeve, të rrisë kostot ose të sjellë pasoja të papritura.*
- *Përmbledhni vlerësimin e opsioneve:*
 - *Paraqisni një pasqyrë përmbledhëse të të gjitha ndikimeve të opsioneve të analizuara.*
 - *Shpjegoni se si ndikimet e të gjitha opsioneve të analizuara krahasohen me njëra-tjetrën.*

- *Paraqisni përlllogaritjet më të mira të përgjithshme neto të ndikimit me vlerë monetare të përcaktuar për çdo opsion (përdor tabelën në Aneksin 2/b të këtij dokumenti).*

Operatorët Ekonomikë/Biznesi: Në Shqipëri në fund të vitit 2021, rezultonin të autorizuar nga AKEP, për ofrimin e rrjeteve dhe/ose shërbimeve të komunikimeve elektronike, mbi 200 sipërmarrës. Për **qeverinë**, opsioni i preferuar do të sjellë arritjen e një objektivi strategjik për një shoqëri gigabit. **Qytetarët do të përfitojnë pasi** zhvillimi i infrastrukturës të komunikimeve elektronike dhe shërbimet e ofruara mbi to me cmime të përballeshme dhe të kudondodhura, rrisin mundësinë e përfitimit nga transformimi digjital dhe përdorimi i TIK nga çdo individ, në marrjen e shërbimeve, aplikacioneve, përdorimin e teknologjive të reja, krijimin e hapësirave për punësim, edukim, e-health, e-commerce etj

Opsionet e ndryshme vlerësohen sipas tre kritereve thelbësore:

1. Efektiviteti: shkalla në të cilën opsionet do të adresojnë problemet e identifikuara dhe do të arrijnë objektivat e dëshiruara;
2. Efikasiteti: koha e mundshme e marrë për të arritur rezultate dhe kostoja shoqëruese e opsioneve të politikave për rregullatorët dhe palët e interesuara;
3. Koherenca: shkalla në të cilën opsionet e politikave ofrojnë stabilitet në lidhje me mekanizmat aktualë si dhe koherencë të brendshme me qasjet e marra për tema të tjera.

Ne gjithashtu konsiderojmë nëse masat janë koherente në lidhje me masat e jashtme si ligji i konkurrencës, Rregullorja e Rregullores së Tregut Unik të Telekomunikacionit (TSM) dhe Direktiva për Reduktimin e Kostos për zhvillimin e Broadband.

Arsyeja për zgjedhjen e këtij opsioni është për shkak të zgjerimit të VHC me Broadband dhe efekteve të tij në infrastrukturën dhe shërbimet e përmirësuara të Broadbandit në ekonominë me bazë më të gjerë. Analiza ekonometrike³⁶ ka gjetur një lidhje midis rritjes së shpejtësisë mesatare të Broadband-it dhe produktivitetit total të faktorëve në një sërë sektorësh. Analiza sugjeron që rritja e vlerësuar e shpejtësisë dhe cilësisë së lidhur me arritjen e të gjithë FTTH në të gjithë BE-në deri në vitin 2025, do të rezultojë në nivele të PBB-së 2% më të larta se status quo-ja deri në vitin 2025, ose një rritje prej 0.76% mbi status quo-në, në një skenar më shumë realist, në të cilin deri në vitin 2025, 62% e lidhjeve Broadband do të bazohen në FTTH/B.

Parashikimet e PBB-së shqiptare bazohen në parashikimet e Bankës Botërore dhe DG ECFIN të BE-së. Parashikimet e Bankës Botërore tregojnë se rajoni i Ballkanit Perëndimor është përmirësuar ndjeshëm, me rritjen e PBB-së që tani parashikohet të arrijë në 5.9 përqind në 2021, pas një tkurrjeje prej 3.1 përqind në 2020. Rritja në rajon parashikohet në 4.1 përqind në 2022, 3.8 përqind në 2023 Kjo është gjerësisht në përputhje me Parashikimin Pranveror të BE-së 2022, i cili sheh rritjen e PBB-së në 8.5% në 2021, 2.7% në 2022 dhe 3.1% në 2023 me një rikuperim të fortë fillimisht nga kufizimet Covid-19 duke u moderuar nga ndikimi i Ukrainë. Tendenca e rritjes afatgjatë e Shqipërisë ka qenë 3% në vit dhe supozohet se do të kthehet në atë rrugë në vitet në vijim.

Tabela 1: Përfitimet e mundshme ekonomike që rezultojnë nga ndryshimet e politikave³⁷

SKENARI	VITI 1 (2025)	VITI 2	VITI 3
2% GDP	309 Milion EUR	318 Milion EUR	328 Milion EUR
0.65% GDP	108 Milion EUR	111 Milion EUR	115 Milion EUR

³⁶ WIK 2015, Mbështetje për përgatitjen e vlerësimit të ndikimit që shoqëron rishikimin e kuadrit rregullator për komunikimet elektronike (SMART 2015/0005), Studim për Komisionin Evropian (2015-2016).

³⁷ Shih parashikimin e Komisionit të BE-së për Shqipërinë, https://ec.europa.eu/economy_finance/forecasts/2022/spring/ecfin_forecast_spring_2022_al_en.pdf

Parashikimet dhe ekstrapolimet e Bankës Botërore shih. Shih NJOFTIMIN E SHTYPIT NR: 2021/ECA/30 të Bankës Botërore.

Gjetjet konfirmojnë atë që literatura sugjeron: përtej përfitimeve ekonomike që rrjedhin nga standardi i Broadband³⁸, rrjetet VHC mund të sjellin përfitime në drejtim të rritjes së punësimit dhe produktivitetit, duke kontribuar në rritjen e PBB-së.

Përvoja nga zbatimi i kuadrit rregullator në Portugali, Spanjë dhe Francë, sugjeron që ndjekja e një strategjie rregullatore, e cila nuk imponon detyrime "standarde" të aksesit për rrjetet e reja VHC, me kusht që ato të shoqërohen nga masa të forta për t'u mundësuar operatorëve alternativë të 'ngjisin shkallët e investimeve' drejt konkurrencës së bazuar në infrastrukturë në FTTH/B, (siç është një mundësi e arsyeshme për të bashkë-investuar në rrjete të tilla, aksesit në kanal (duct access) dhe mirëmbajtja e detyrimeve të aksesit në rrjete në nivelin e performancës përpara përmirësimit (upgrade), mund të shkaktojë disponueshmëri më të gjerë të FTTH/B në të gjithë territorin kombëtar.

Masat e përshkruara më sipër do të nxisin konkurrencën në infrastrukturë dhe do ta sjellin atë në zona ku në mungesë të dispozitave efektive për aksesin në kanal/pol nuk do të kishte funksionuar, duke krijuar një fushë më të barabartë konkurruese midis operatorëve aktualë dhe konkurrentëve. Analiza e shkaqeve themelore të investimeve jooptimale, tregon se zgjidhjet rregullatore nuk e zgjidhin automatikisht problemin e investimeve, pasi disa nga faktorët që ndikojnë në investime janë të natyrës makroekonomike ose socio-ekonomike.

Përvoja suedeze tregon se modelet vetëm me shumicë mund të ndihmojnë në zgjerimin e gjurmës së NGA-së, duke u fokusuar në modelet e investimeve në infrastrukturë, me kthime më të gjata në kapital, duke tërhequr investitorë që kanë nevojë për kthime më të ulëta por të vazhdueshme, për një kohëzgjatje më të gjatë të aseteve. Kjo është gjithashtu koherente me iniciativat e tjera të BE-së, të tilla si heqja e rrezikut nga CEF/EFSI e projekteve të investimeve nëpërmjet instrumenteve financiare, të cilat mund të zbatohen lehtësisht për financimin e projekteve të infrastrukturës si rrjetet VHC. Në përvojën suedeze, kërkesa për agregim, nxitet edhe nga mundësia e "pagesës paraprake", e cila imitohet nga masa e propozuar për pagesat me këste, e përshtatshme për zonat rurale ku shumë banorë zotërojnë pronat e tyre.

Duhet të theksohet gjithashtu se mbulimi i konektivitetit me gjerësi bande shumë të lartë në Portugali dhe Spanjë, është shtrirë gjithashtu përtej zonave urbane shumë të dendura dhe kishte arritur në 83% të të gjitha familjeve në Portugali dhe 88% të të gjitha familjeve në Spanjë.³⁹


Sipas një dokumenti nga Shortall dhe Cave⁴⁰, strategjia rregullatore e përdorur në Francë, Portugali dhe Spanjë, e cila mund të përshkruhet si një version i fortë i teorisë konvencionale të 'shkallës së investimit', e kombinuar me rregullimin simetrik të instalimeve elektrike në ndërtesa, është gjithashtu, e lidhur me një ndarje dukshëm më të barabartë të shtëpive të furnizuara midis operatorëve aktualë, nga njëra anë, dhe operatorëve alternativë të komunikimeve elektronike, nga ana tjetër, sesa është rasti në Gjermani, Mbretërinë e Bashkuar ose Belgjikë, ku hyrjet kanë qenë më të varur nga aksesit kryesisht aktiv në infrastrukturën ekzistuese. Në këtë kuptim, me kalimin e kohës, kjo qasje mund të çojë në një formë konkurrence më të qëndrueshme, sesa qasjet që mbështeten më shumë në aksesin në infrastrukturën ekzistuese të operatorit aktual.

³⁸ Për shembull Waverman, L. (2009, 29 shkurt). Ndikimi ekonomik i brezit të gjerë: Një studim empirik. Londër: LECC zbulon se një rritje prej 1% në penetrimin e brezit të gjerë në vendet me të ardhura të larta dhe të mesme çon në 0.13% rritje të produktivitetit

³⁹ FTTH Këshilli i Evropës, Panorama e Tregut 2021 – Të dhënat në shtator 2020. E disponueshme në <https://www.ftthcouncil.eu/>

⁴⁰ Shortall dhe Cave, Komunikimet & Strategjitë Nr. 98 T2 2015.


Telecom Operator Type by Country - 2014



Ndjekja e qasjeve të tilla si ato të ndërmarra në Francë, Spanjë dhe Portugali, nga NRA-të, mund të përfshijë më shumë përpjekje të paktën në fazat fillestare në hartimin e disponueshmërisë së kanaleve (ducts) dhe mbivendosjes së infrastrukturës së rrjetit, si dhe në funksionalizimin e zgjidhjes së aksesit në kanal.

Një avantazh i Shqipërisë në ndjekjen e acquis të BE-së, është se tashmë ka prova që vijnë nga Europa, se qasja e propozuar në draftin e EECC, i cila u draftua në 2016, u finalizua në 2018 dhe hyri në fuqi në 2020, është efektive, pasi ajo tashmë po jep fryte siç mund të jetë parë nëpërmjet investimeve të përshpejtuara në një numër shtetesh anëtare të BE-së.

Duke vezhguar vendet e përmendura më sipër, të cilat paraprakisht ndoqën një strategji të zgjeruar të rrjetit të bakrit dhe me kalimin e kohës gjurmimin e investimeve në VHCN, ajo që mund të shihet është se një zhvendosje e parë në sendiment në 2016, pasohet nga zhvendosje të mëtejshme në trajektoren e investimeve në 2018 dhe 2020, teksa Acquis e re kaloi nëpër faza të ndryshme nga propozimi në miratim dhe në fund në pasjen e efektit ligjor.



Në përgjithësi, mund të shihet se masat për promovimin e rrjeteve VHC janë të dëshirueshme dhe të nevojshme dhe se masat legislative të propozuara mund të japin rezultatet e dëshiruara.

Vlerësimet e kostove dhe përfitimeve të opsionit të preferuar; Opsioni 2.

Për secilin prej opsioneve të ndryshme të shqyrtuara, ka indikacione se AKEP dhe MIE do t'u duhet të kryejnë detyra të ndryshme. Në opsionin 3 të zgjedhur, frekuenca e rishikimeve të tregut do të zgjerohet, kështu që kjo do të pakësojë burimet e kërkuara. Në mënyrë të ngjashme, përdorimi i një standardi të jashtëm për përcaktimin e tarifave fundore celulare dhe fikse, duhet të çojë në më pak burime të dedikuara për procedurat e analizës së tregut. Elementë të tjerë, veçanërisht fokusi në analizën gjeografike të tregut, si dhe përdorimi i aksesit më të fokusuar në infrastrukturën e inxhinierisë civile, ka të ngjarë të çojnë në rritjen e punës për AKEP-in, veçanërisht nga status quo-ja që mbizotëron sot.

Shkalla, në të cilën burimet shtesë të nevojshme për të përfunduar ushtrimet e plota të hartës dhe analizat gjeografike, do të kompensohen nga zgjatja e procesit të analizës së tregut në pesë vjet dhe si rezultat i specifikimeve të standardizuara të produktit me shumicë, të cilat mund të heqin nevojën për disa prej proceseve të dyfishta që kanë ndodhur në nivel kombëtar (d.m.th. tarifën e përfundimit), të cilat vlerësohen më poshtë.

Shkalla, në të cilën burimet shtesë të nevojshme për të përfunduar ushtrimet e plota të hartës dhe analizat gjeografike, do të kompensohen nga zgjatja e procesit të analizës së tregut në pesë vjet dhe specifikimeve të standardizuara të produktit të shumicës, gjë që sjell evitimin e nevojës për disa procese të dyfishta që ekzistojnë në nivel kombëtar (d.m.th. tarifën e përfundimit), dhe kjo shkallë vlerësohet si më poshtë.

Nëse mund të bëhen kursime të kostos në nivel kombëtar prej rreth 15%, si rezultat i thjeshtimit të procesit të analizës së tregut, veçanërisht zgjatjes së periudhës së rishikimit të tregut nga 3 në 5 vjet, e reduktimit të mundshëm të numrit të tregjeve që do të analizohen dhe nëse këto burime të lira mund të rridheshin në këto "mapping exercises", mund të ndodhë që nuk do të kërkohej burime shtesë.

Megjithatë, kostot kryesore të arritjes së mbulimit dhe marrjes së VHCN-së do të bien mbi sektorin privat, megjithëse me disa mbështetje publike. Studimi i Fizibilitetit i WBIF-së, përmes Raportit të Modelit të Kostos së Zhvillimit të Broadband-it, detajon kostot e zbatimit të Infrastrukturës Broadband, në mënyrë që të arrihet shoqëria gigabit. Raporti ofron katër skenarë zhvillimi (një përzierje e rrjeteve me fibra dhe zgjidhjeve të rrjeteve pa tel) dhe një vlerësim të kostos për secilën prej tyre për një periudhë 20-vjeçare⁴¹.

Sipas Bankës Qëndrore të Shqipërisë⁴², PBB-ja e Shqipërisë ishte afërsisht 13 miliardë euro në vitin 2020. Nëse shikojmë më pas gamën e rezultateve të identifikuar në studimin e Komisionit të BE-së⁴³, i cili përdori analizën ekonomike dhe modelin makroekonomik, për të vlerësuar se çfarë do të arrinte shpejtësinë mesatare të pritshme në një skenar të plotë me fibra deri në vitin 2025, kjo do të rriste PBB-në e BE-së dhe ndikimi pritej të ishte një rritje në PBB prej 2% krahasuar me status quo-në dhe me 0.7% në një skenar në rritje me shpejtësi të lartë (ku vetëm 62% e familjeve kishin akses në Broadband të lidhur me VHCN).

Zbatimi i kësaj ngritjeje objektive në shifrat e PBB-së së Shqipërisë, sugjeron që PBB-ja ka të ngjarë të rritet nga 91 milion në 260 milion €, duke supozuar zbatimin e parametrave të rritjes ekuivalente.

Përveç përfitimeve të qarta të drejtpërdrejta ekonomike nga ndjekja e opsionit 3, ka një sërë përfitimesh të tjera që nuk janë lehtësisht të matshme dhe jo domosdoshmërisht të konsideruara nga aktorët e tregut, por megjithatë të rëndësishme nga këndvështrimi i politikave.

41 <https://www.infrastruktura.gov.al/wp-content/uploads/2020/07/VKM-434-date-3.6.2020-Per-miratimin-e-Planit-Kombetar-per-Zhvillimin-e-Qendrueshem-te-Broadband-2020-2025.pdf>

42 Raporti Vjetor 2020. Raporti Vjetor është miratuar me Vendimin nr. 12 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, datë 3.3.2021; Pasqyrat Financiare të Bankës së Shqipërisë janë miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 16, datë 24.03.2021.

43 Mbështetje për përgatitjen e vlerësimit të ndikimit që shoqëron rishikimin e kuadrit rregullator për komunikimet elektronike. Një studim i përgatitur për Rrjetet, Përbajtja dhe Teknologjia e Komunikimit të DG të Komisionit Evropian nga: WIK, ECORYS dhe VVA 2015. ISBN 978-92-79-61797-3

Shumë nga përdorimet e mundshme të FTTH, të tilla si puna në shtëpi dhe aplikacionet e Shëndetit elektronik në shtëpi, kanë ndikime të rëndësishme që lidhen me to, të cilat mund të klasifikohen si eksternalitete pozitive ekonomike. Në rastin e punës në shtëpi, ky mund të jetë lehtësim i bllokimit të trafikut duke lejuar udhëtarët e tjerë të kursejnë kohë si dhe ka ndikime pozitive mjedisore. Në rastin e aplikimeve të shëndetit elektronik në shtëpi, lehtësohet dekonjestioni i kujdesit shëndetësor dhe përveç përfitimeve të drejtpërdrejta, mund të parashikohen kursime financiare për shtetin. Është e qartë se fokusi i të gjitha këtyre përfitimeve focus ka ndodhur me fillimin e krizës Covid-19.

Megenëse përfitimet që rrjedhin nga shoqëria shpesh shkojnë përtej përfitimeve të drejtpërdrejta ekonomike të identifikuar nga investitorët, financat publike janë të justifikuar pasi këto përfitime i në përgjithësi i drejtohen shoqërisë. Një studim⁴⁴ që shqyrton përfitimet socio-ekonomike të fibrave, zbuloi se ofrimi i fibrave në nivel komunal, konsiderohet të ketë përfitime pozitive për shëndetin, arsimin dhe shërbimet e tjera për publikun. Këto përfitime variojnë nga kostot e reduktuara të telekomunikacionit, deri te shërbimet më efikase dhe të reja. Kjo është veçanërisht e vërtetë në zonat rurale, ku burimet dhe distanca e kufizuar janë pengesa për cilësinë e shërbimit dhe instalimin e ndërmarrjeve dhe zhvillimin e tyre. Në kontekstin e eksternaliteteve pozitive, ndërhyrja më e madhe publike mund të justifikohet (në të vërtetë ky është arsyeja e ndihmës shtetërore në radhë të parë).

Në rastet kur sektori privat nuk mund të ndërtojë rrjetin VHCN, atëherë përdorimi i fondeve publike për të mbështetur një shtrirje të gjerë të VHCN është i justifikuar pasi do të lehtësojë përfitimet për zhvillimin ekonomik dhe social dhe përdorimin e rrjeteve FTTH.

Spektri

Opsioni 0. Ky opsion është nga natyra e tij i larmishëm dhe i paparashikueshëm, duke i bërë kështu variablat e analizës së kostos dhe përfitimit shumë të gjera për të përcaktuar një vlerësim. Megjithatë, është e qartë se sipas këtij skenari, mund të bëhen parashikime të pamjaftueshme për t'i mundur Shqipërisë të kapërcejë vështirësitë me të cilat përballet futja e 5G. Edhe pse sipas kuadrit aktual, menaxhimi ekzistues i spektrit as nuk ofron siguri të mjaftueshme rregullatore (d.m.th. disponueshmërinë në kohë të spektrit dhe kushtet përkatëse të autorizimit) dhe as nuk krijon kushtet e nevojshme për investime dhe inovacion.

Pjesa më e madhe e kostos oportune do të binte mbi ato vende që janë më pak të avancuara për sa i përket mbulimit LTE dhe depërtimit në treg. Një studim i DG ECFIN, vlerëson ndikimin e reformës së spektrit në arritjen e objektivave të DAE në 0,3-0,4% të PBB-së⁴⁵ së BE-së. Në mungesë të një reforme të tillë sipas Opsionit 1, kjo përkthehet në një kosto oportune siç tregohet më poshtë

Tabela 2: Ndikimi i reformave të spektrit

SKENARI	VITI 1 (2025)46	VITI 2	VITI 3
0.4% GDP	62 Million EUR	64 Million EUR	66 Million EUR
0.3% GDP	46 Million EUR	48 Million EUR	49 Million EUR

Për sa i përket shtrirjes së rrjetit 5G, ky opsion nuk do të krijojë kushtet e duhura për një ekosistem inovativ që do të mbështeste përfitimet e plota të teknologjive 5G në BE.

Ndikimet sociale dhe mjedisore

Ka katër ndikime kryesore sociale që duhet të merren parasysh në të gjitha opsionet:

⁴⁴ Ndikimi socio-ekonomik i FTTH 05 shkurt 2018 WIK-Consult GmbH

⁴⁵ Dimitri Lorenzani, Janos Varga, Ndikimi ekonomik i reformave strukturore dixhitale. Shiko:

http://ec.europa.eu/economy_finance/publications/economic_paper/2014/ecp529_en.htm

- Dështimi për të hequr potencialin për punësim që lidhet me arritjen e objektivave të DAE në Shqipëri dhe me vendosjen e suksesshme (d.m.th. të shpejtë dhe të koordinuar) të shërbimeve 5G
- Rritja e divergjencave për lidhjen celulare në ato zona që mbeten prapa në vendosjen e rrjeteve 4G dhe prezantimin e shërbimeve 5G. Si pasojë, ka të ngjarë të shohim në disa zona, një përkeqësim të ndarjes digjitale.
- Reduktim i aksidenteve rrugore dhe rritje e blerjeve online si rezultat i 5G.
- Humbja e potencialit në industritë vertikale, që do të përfitonin më shumë nga vendosja e rrjetit 5G me pasoja për përdoruesit e atyre industrive (p.sh. në sektorët e shëndetësisë elektronike, transportit, shërbimeve komunale dhe automobilave). Për shembull, kjo mund të nënkuptojë përfshirje më të ulët sociale dhe pabarazi më të mëdha shëndetësore.

Këto kosto oportune janë të mëdha në tregun shqiptar.

Opsioni 1. Prezantimi i objektivave dhe parimeve më specifike të lidhura me spektrin do të krijojë presion për të lejuar një akses në kohë në spektrin për shërbimet inovative 5G në Shqipëri – në veçanti, nëse arrihet një mbulim minimal territorial (përfshirë infrastrukturën kryesore të transportit), ai do të lehtësojë vendosjen e vertikaleve 5G si makinat e lidhura. Për më tepër, kur vendosen parimet e përgjithshme të zbatueshme për tarifën e licencës, maksimizimi i të ardhurave në ankande nuk do të jetë më në thelb të projektimit të ankandit. Kështu, operatorët do të kenë më shumë kapital në dispozicion për të investuar në rrjete me performancë të lartë për të përmbushur nevojat e kudondodhura të konektivitetit.

Megjithëse opsioni 2 krijon një kornizë që promovon praktikën më të mira, natyra e tij jodetyruese nuk do të sigurojë konsistencën e menaxhimit të spektrit radio, një qasje e tillë e kujdesshme nuk do të ketë ndikim pozitiv në treg (duke përfshirë promovimin e tregjeve të spektrit dytësor të BE-së) dhe, si është rasti i skenarit bazë, dështon të arrijë një përfaqësim të tregut të vetëm për politikën dhe menaxhimin e spektrit, siç është përcaktuar si objektiv në DSM dhe reflektuar në “Planin Kombëtar Shqiptar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale Broadband 2020-2025”.

Opsioni 2. Ky opsion do të ketë një sërë ndikimesh pozitive. Së pari, kohëzgjatjet afatgjata të licencës të propozuara në këtë opsion, do të rrisin stabilitetin dhe sigurinë e investimeve, si dhe kërkesat për inovacion. Përveç kësaj, zgjatja e afatit të licencës, do të krijojë kushtet e duhura për lulëzimin e tregjeve të spektrit dytësor. Përfitimet e mundshme të tregjeve të spektrit për rritjen e efikasitetit të alokimeve të spektrit, pranoen gjerësisht pasi tregjet e spektrit lejojnë një përdorim më efikas dhe dinamik të spektrit. Ndarjet e spektrit për aplikime të ndryshme nga ndërhyrjet rregullatore, janë zakonisht statike, d.m.th. negociatat ndërkombëtare të kërkuara për rregullimin e spektrit⁴⁷ zbatohen për shumë vite. Prandaj ndryshimet në kërkesat e trafikut, aplikacionet e mundshme, preferencat e përdoruesve dhe teknologjitë e disponueshme me kalimin e kohës dhe vendndodhjeve mund të çojnë në përdorim joefikas të burimeve të spektrit. Tregu sekondar i spektrit, lejon një shpërndarje dinamike të burimeve të spektrit, duke iu përshtatur këtyre variacioneve në shkallë kohore dhe gjeografike. Kështu, teknologjitë dhe shërbimet e reja kanë akses më të lehtë në spektër.

Së dyti, krijimi i një kuadri për detyrimet e mbulimit sipas nevojës (që do të përfshijë edhe infrastrukturën kryesore të transportit), do të krijojë kushtet e duhura për të përmbushur nevojat e konektivitetit të Planit Kombëtar Shqiptar për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Infrastrukturës Digjitale në masën e realizueshme nëpërmjet 5G wireless. Konsistenca e detyrave dhe kushteve të përdorimit do të përmirësohet dhe kostot do të reduktohen në krahasim me detyrat tradicionale. Qëllimi i këtij opsioni do të ishte rritja e koordinimit dhe shpejtësisë së detyrave.

⁴⁷ Konferenca Botërore e Radiokomunikacionit (WRC), Konferenca e Unionit Ndërkombëtar të Telekomunikacionit (ITU) e cila rishikon rregulloret detyruese të radios të paktën çdo 3 vjet.

Së fundi, do të promovojë një përdorim fleksibël dhe efikas të spektrit për t'iu përgjigjur sfidave të ardhshme 5G. Një lëvizje drejt një modeli licencimi më gjerësisht të bazuar në autorizimet e përgjithshme veçanërisht për brezat më të lartë të spektrit, nëse shoqërohet me harmonizim ndërkufitar, do të nënkuptonte që operatorët mund të kishin të njëjtin spektër në të gjithë Evropën, me kushte të ngjashme. Një sistem i tillë mund të përshpejtojë me shpejtësi kohën për në treg, pasi nuk do të nevojiten vendime (qoftë në nivel kombëtar apo të BE-së) se kush do të marrë spektrin dhe cilin lloj të tij, qasja në spektër do të jetë më e shpejtë për operatorët.

Ky opsion përfshin njëfarë reduktimi në shkallën aktuale të fleksibilitetit kombëtar në lidhje me caktimet e spektrit. Shpërblimi për këtë humbje të fleksibilitetit është caktimi më i shpejtë i spektrit. Paralelisht, konsistenca më e madhe e detyrave, veçanërisht për kushtet e licensave afatgjata, do të nxisë tregtimin dhe qiradhënien e spektrit dhe do të hapë rrugën për krijimin e një tregu dytësor të spektrit. Këto efekte nuk do të arriheshin në mënyrë efektive me udhëzime vullnetare.

Ky opsion mund të çojë në një qasje të koordinuar për menaxhimin e spektrit, që lejon një shtrirje në kohë të 5G në Shqipëri, ndërkohë që mundëson një integrim midis inovacionit teknologjik dhe aksesit në rrjetet e kudogjendura dhe VHC.

Analiza e kostos dhe e përfitimeve

Përveç ndikimit të vlerësuar në bazë të ekonomisë, të përfshira në tabelat 1 dhe 2, mund të parashikohen disa ndikime të drejtpërdrejta që rezultojnë nga ndryshimet në politikat e propozuara. Lëvizja drejt një theksimi më të madh në analizën gjeografike do të kërkojë më shumë burime për AKEP-in, si dhe punë shtesë në lidhje me aksesin në inxhinierinë civile. Nga ana tjetër, disa aspekte të tilla si kalimi në cikle më të gjata të rishikimit të tregut mund të pakësojnë kërkesat e stafit në AKEP. Detaje të mëtejshme do të mbliidhen në procesin e konsultimit për të përmirësuar këto vlerësime.

Në fushën e spektrit, lëvizja drejt licensave më të gjata, e kombinuar me theks më të madh në ndarjen e spektrit dhe tregtimin e spektrit, mund të kompensojë njëri-tjetrin në terma buxhetorë, d.m.th. më pak ngjarje ankandesh mund të kompensohen nga taksat e shitjeve dhe tarifat e tjera në një treg aktiv transferimi.

Tabela 3: Ndryshimet Legjislative të Kostove dhe Përfitimet:

Opsion/Viti	Viti 2025	2026	2027
Opsion 0 Kostot	-	-	-
Opsion 0 Perfitimet	-	-	-
Opsion 1 Kostot	TBD	TBD	TBD
Opsion 1 Perfitimet	<108 Milion EUR	<111 Milion EUR	<115 Milion EUR
Opsion 2 Kostot	TBD	TBD	TBD
Opsion 2 Perfitimet	309 Milion EUR	318 Milion EUR	328 Milion EUR

Tabela 4: Kostot dhe përfitimet e spektrit:

Opsion/Viti	Viti2025	2026	2027
Opsion 0 Kostot	-	-	-
Opsion 0 Perfitimet	-	-	-
Opsion 1 Kostot	TBD	TBD	TBD
Opsion 1 Perfitimet	<46 Milion EUR	<48 Milion EUR	<49 Milion EUR
Opsion 2 Kostot	TBD	TBD	TBD
Opsion 2 Perfitimet	62 Milion EUR	64 Milion EUR	66 Milion EUR

Trade-offs

Trade off –et e mundshme midis kontributit në lidhjen e kudogjendur VHC, konkurrencës dhe zgjedhjes së përdoruesit në Shqipëri.

Konkurrenca e bazuar në akses është dhe ka qenë një shtytës efektiv i investimeve në fusha të caktuara, kështu që investimi dhe rrjedhimisht konektiviteti nuk duhet të shihen në kundërshtim me konkurrencën. Nje *trade off* i mundshëm mund të shfaqet, ndërmjet atyre objektivave specifike në rast se konektiviteti ndiqet në kurriz të konkurrencës. Propozimi i rregullores së aksesit do të jetë në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 7 të ligjit 9918, duke përfshirë konkurrencën dhe nuk do të modifikojë regjimin e SMP aktualisht në fuqi dhe as nuk do të sigurojë të ashtuquajturat "festa rregullatore", që do të përfitojnë aktorë të caktuar të tregut në një treg të pabarabartë. Së fundi, një përkufizim shumë ambicioz i USO-së përsa i përket shpejtësisë, disponueshmërisë ose përbalueshmërisë, mund të rrezikojë dinamikën e konkurrencës midis aktorëve të tregut dhe të imponojë përfitime të tepërta ose të financuara nga publiku, për operatorët e identifikuar si ofrues të USO-së.

Trade off të tjera të mundshme janë ndërmjet kontributit në lidhjen e përhapur VHC dhe thjeshtimit të ndërhyrjes rregullatore dhe koherencës së tregut të vetëm. *Trade off* kryesor që mund të parashikohet midis këtyre dy objektivave, mund të ndodhë në rast të një derregullimi të gjerë që do të largonte rregullimin ex-ante të tregut nga ato tregje që mund të konsiderohen ende si pengesa për ofrimin e shërbimeve të komunikimeve elektronike, me gjasë të dobësimit presioni i investimeve si dhe konkurrenca e shërbimeve, mundësitë e hyrjes në treg në tregun e vetëm dhe përfitimet e konsumatorëve. Për të shmangur një *trade off* të tillë, një numër opsionesh që janë marrë në konsideratë në shkallë të parë për shkak të efekteve të tyre të mundshme në drejtim të thjeshtimit, janë hedhur poshtë, siç është çrregullimi i plotë i rrjeteve të telekomunikacionit në zonën e aksesit ose përfundimi i regjimit të USO. Nga ana tjetër, ndjekja e lidhjes së VHC mund të sjellë legjislacion shumë ndërhyrës për sa i përket teknologjisë dhe vendimeve të biznesit që potencialisht mund të bëj ri-rregullimin e industrisë. Një *trade off* i mundshëm mbetet ende kur ndryshohen ciklet e rishikimit të tregut në 5 vjet, por që gjithsesi zbutet nga një sërë masash mbrojtëse.

Ekzistojnë gjithashtu *trade off* të mundshme midis konkurrencës, zgjedhjes së përdoruesit, thjeshtimit të ndërhyrjes rregullatore dhe koherencës së tregut të vetëm. Shkëmbimet e mundshme që mund të parashikohen midis këtyre objektivave lidhen kryesisht me balancën që duhet të arrihet gjatë rregullimit të shërbimeve të reja. Për shembull, një interpretim ekstrem i konceptit të fushës së lojës së barabartë mund të çojë në imponimin e rregullave të kuadrit rregullator për të gjitha shërbimet Over the Top, pavarësisht nga shkalla e zëvendësimit që ekziston me ofruesit aktual të Shërbimit të Komunikimit Elektronik (ECS) ose nga shkalla e operacioneve të tyre. Kjo ndoshta do të pengonte inovacionin dhe nuk do të përfitonte nga konkurrenca, në mënyrë që ky opsion të mos ndiqet.

Arsyetimi i opsionit të preferuar

- Zgjidhni opsionin e preferuar, bazuar në analizë.
- Shpjegoni arsyetimin tuaj.

Opsioni i preferuar është përzgjedhur Opsioni 2, pra hartimi dhe miratimi i një ligji të ri “Për komunikimet elektronike në RSH”, pasi:

- Legjislacioni i ndryshuar do të përforcojë lidhjen midis objektivit të kuadrit rregullator dhe objektivave të përgjithshme politike të qeverisë shqiptare. Ai do të lejojë Shqipërinë të marrë pjesë plotësisht në zhvillimet e ardhshme të shërbimeve dhe rrjeteve të komunikimeve elektronike, si 5G IoT, ose Inteligenca Artificiale.
- ofron një model të ri për zhvillimin e infrastrukturës së komunikimeve elektronike shumë të shpejtë mbi bazën e një rregullimi simetrik, bashkëpërdorimin e infrastrukturës dhe burimeve, krijimit të lehtësirave për zhvillimin e rrjeteve dhe shërbimeve në një mjedis rregullator më të përshtatshëm bazuar në zhvillimet teknologjike.

- Ndhmon në reduktimin e ndarjes digjitale përmes zhvillimit të rrjeteve dhe shërbimeve universale të përballueshme dhe gjithëpërfshirëse;
- Përcakton një objektiv të rëndësishëm strategjik për rrjetet e kapaciteteve të larta dhe shumë të larta;
- Sjell standardin e BE-së në këtë fushë, dhe synon garantimin e Kartës së Drejtave Themelore të BE,⁴⁸ në zbatimin e rregullave për komunikimet elektronike dhe adresimin e masave të planifikuara në këtë drejtim;
- realizon objektivat politike të qeverisë për zhvillimin e infrastruktures digjitale dhe ofrimin e shërbimeve elektronike;
- mundëson adresimin e problematikave të tregut;
- në këndvështrimin e kostos, opsioni i preferuar rezulton me pozitiv.

Çështje të zbatimit

- *Shpjegoni se cila strukturë do të jetë përgjegjëse për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Shpjegoni pengesat e mundshme për zbatimin e opsionit të zgjedhur.*
- *Përshkruani masat që do të ndërmerren gjatë zbatimit për të arritur qëllimet e politikës.*

Institucionet përgjegjëse për zbatimin dhe monitorimin e opsionit të preferuar janë:

MIE si institucion politikëbërës për tregun e komunikimit elektronik/telekomunikacionit;

- AKEP si organ i pavarur rregullator për tregun e komunikimeve elektronike dhe përgjegjëse për zbatimin e mbikqyrjen e tregut të komunikimeve elektronike;
- AMA si autoriteti rregullator i transmetimeve audiovizive dhe përgjegjës për mbikqyrjen e tregut të medias;
- Institucione të tjera publike/autoritete kompetente të lidhura ose/të ngarkuara për aspekte të tilla si, siguria, përdorimi i spektrit (Ministria e Mbrojtjes, Ministria e Brendshme dhe Shërbimi Informativ Shtetëror), Autoriteti i Konkurrencës, Komisioni për Mbrojtjen e Konsumatorit dhe të Dhënat Personale, Komisioni i Mbrojtjes së Konsumatorit etj me të cilët bashkëpunohet nga ministria dhe AKEP për përmbushjen e objektivave të politikës.

Faza e monitorimit dhe vlerësimit

- *Jepni një përshkrim të përmbledhur të masave të monitorimit dhe të vlerësimit.*
- *Identifikoni kriteret/treguesit për të matur arritjen e objektivave ose progresin drejt tyre.*

Zbatimi i ndryshimeve të politikave të përfshira në opsionin e preferuar do të monitorohet në mënyrë periodike nëpërmjet raporteve vjetore të AKEP, dhe/ose MIE.

Treguesit kryesorë për të matur suksesin e zbatimit të politikave janë:

- Shkalla e penetrimit të broadbandit fikse bazuar në VHCN
- Numri i lidhjeve fikse broadband VHCN - % e mbulimit me rrjete të broadbandit celular të bazuar në VHCN
- Numri i përdoruesve mobile broadband (VHCN-së celulare)
- Përballueshmëria e çmimeve dhe shërbimeve broadband;
- Shfrytëzimi i shërbimeve digjitale nga biznesi dhe shërbimet publike.

⁴⁸ Vlerësimi i ndikimit në rishikimin e Direktivës 2003/98/KE për ripërdorimin e informacionit të sektorit publik' i BEsë referon hapjen e 100,000 vendeve të punës në total në Shtetet Anëtare të BE-së përmes tregut të open data dhe ripërdorimitëëëëëëëë

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/a

Tabela: Vlera aktuale neto në total (VAN) - kostot dhe përfitimet me vlerë monetare të përcaktuar në milionë lekë e zbritur për 10 vjet (Vlera aktuale e kostos dhe vlera aktuale e përfitimit); krahasuar me status quo-në.

	Viti 1	Viti 2	Viti 3	Viti 4	Viti 5	Viti 6	Viti 7	Viti 8	Viti 9	Viti 10
Faktori zbritës										
Kosto për buxhetin - një herë										
Kosto për buxhetin - në vazhdimësi										
Kosto për bizneset - një herë										
Kosto për bizneset - në vazhdimësi										
Kosto për grupet e tjera - një herë										
Kosto për grupet e tjera - në vazhdimësi										
Kosto në total										
Kosto e zbritur= Kosto në total x Faktori zbritës										
Përfitimet për buxhetin – një herë										
Përfitimet për buxhetin – në vazhdimësi										
Përfitimet për grupet e tjera – një herë										
Përfitimet për grupet e tjera – në vazhdimësi										
Përfitimet për biznesin – një herë										

Përfitimet për biznesin – në vazhdimësi										
Përfitimet totale										
Përfitimi i zbritur = Përfitimi në total x faktori zbritës										
Vlera prezente aktuale e përfitimit në total										
Vlera prezente aktuale e kostos në total										
Vlera Prezente Neto Aktuale (VAN) = Vlera aktuale e përfitimit në total – Vlera aktuale e kostos në total										

Raporti i vlerësimit të ndikimit - Shtojca 2/b

Tabelë: Vlera aktuale neto në total e çdo opsioni

Opsioni	Vlera aktuale në milionë lekë		Vlera aktuale neto në milionë lekë
	Kosto	Përfitimi	
Opsioni 1	0	0	0
Opsioni 2	0	0	0

MINISTËR

[Emri Mbiemri]